



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.93

21 korrik

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 290 datë 24.6.2010	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për përgjegjësinë civile dhe dëmshpërblimin për dëmet, në lidhje me transportin e lëndëve të rrezikshme dhe helmuese përmes detit, 1996”	4995
Rregullore e MMPAU nr.10, datë 18.6.2010	Për përcaktimin e procedurave për pajisjen me leje dhe të konkurrimit publik për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit në det, në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore	5021
Kërkesë e MPPT nr.3823, datë 22.6.2010	Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Vora By Pass” Tiranë.....	5028
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Josif Karaj	5030

LIGJ
Nr. 10 290, datë 24.6.2010

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
“PËR PËRGJEGJËSINË CIVILE DHE DËMSHPËRBLIMIN PËR DËMET, NË LIDHJE ME
TRANSPORTIN E LËNDËVE TË RREZIKSHME DHE HELMUESE PËRMES DETIT,
1996”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën ndërkombëtare “Për përgjegjësinë civile dhe dëmshpërblimin për dëmet, në lidhje me transportin e lëndëve të rrezikshme dhe helmuese përmes detit, 1996”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6638, datë 13.7.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTA NDËRKOMBËTARE
MBI PËRGJEGJËSINË CIVILE DHE DËMSHPËRBLIMIN PËR DËMET NË LIDHJE ME
TRANSPORTIMIN E LËNDËVE TË RREZIKSHME DHE HELMUESE PËRMES DETIT,
IMO 1996

[Hyrje]

Shtetet palë në këtë Konventë,

të ndërgjegjshme për rreziqet që kanosen nga transportimi përmes detit në të gjithë botën i lëndëve të rrezikshme dhe helmuese,

të bindur për nevojën për të siguruar që dëmshpërblim i përshtatshëm, i menjëhershëm dhe efektiv të jetë i disponueshëm për personat që pësojnë dëme të shkaktuara nga incidente në lidhje me transportin e këtyre lëndëve përmes detit,

duke dëshiruar që të miratojnë rregulla dhe procedura të njëtrajtshme ndërkombëtare për përcaktimin e çështjeve të përgjegjësisë dhe dëmshpërblimit në lidhje me këtë dëm,

duke pasur parasysh se pasojat ekonomike të dëmeve të shkaktuara nga transporti përmes detit i lëndëve të rrezikshme dhe helmuese duhet të ndahen mes industrisë së transportit detar dhe interesave përkatëse të ngarkesave,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Përkufizime
Neni 1

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. “Anije” nënkupton çdo mjet lundrues detar dhe çdo mjet lundrues të përdorur në det, të çfarëdo lloji.

2. “Person” nënkupton çdo individ apo ortakëri ose çdo organ publik apo privat, qoftë shoqëri apo jo, duke përfshirë këtu një shtet apo cilindo nga nënndarjet e tij përbërëse.

3. “Pronar” nënkupton personin ose personat e regjistruar si pronarë të anijes ose, në mungesë të regjistrimit, personin ose personat që kanë në pronësi anijen. Megjithatë, në rast të një anijeje nën pronësinë e një shteti dhe që operohet nga një shoqëri e cila në atë shtet është regjistruar si operuese e anijes, “pronar” do të nënkuptojë këtë shoqëri.

4. “Marrës” nënkupton ose:

a) personin që fizikisht merr një ngarkesë shkaktuese të shkarkuar në portet dhe терминаlet e një shteti palë, me kusht që nëse në kohën e marrjes personi që fizikisht e merr ngarkesën vepron si agjent për një tjetër i cili i nënshtrohet juridiksionit të cilitdo shtet palë, atëherë do të quhet se marrësi është drejtuesi, nëse agjenti e prezanton drejtuesin pranë Fondit të HNS; ose

b) personi në shtetin palë i cili në përputhje me legjislacionin e brendshëm të atij shteti palë vlerësohet se është marrësi i ngarkesës shkaktuese të shkarkuar në portet dhe терминаlet e një shteti palë, me kusht që totali i ngarkesës shkaktuese të marrë në përputhje me këtë legjislacion të brendshëm, të jetë në thelb i njëjtë si ai që do të ishte marrë sipas paragrafit (a).

5. “Lëndë të rrezikshme dhe helmuese” (HNS) nënkupton:

a) çdo lëndë, material apo artikull që transportohet në bordin e anijes si ngarkesë, e përmendur në paragrafët nga (i) në (vii) më poshtë:

i) karburante që transportohen në sasi të mëdha siç janë renditur në bashkëlidhjen I të shtojcës I të Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, të vitit 1973, të ndryshuar nga protokollin e vitit 1978 në lidhje me të, i ndryshuar;

ii) lëndë të lëngshme helmuese që transportohen në sasi të mëdha siç përmenden në bashkëlidhjen II të shtojcës II të Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, të vitit 1973, të ndryshuar nga protokollin e vitit 1978 në lidhje me të, i ndryshuar; si edhe ato lëndë dhe përzierje që janë brenda kategorive të ndotjes A, B, C ose D në përputhje me rregulloren 3 (4) të shtojcës II të përmendur më lart;

iii) lëndë të lëngshme të rrezikshme që transportohen në sasi të mëdha siç janë renditur në kreun 17 të Kodit Ndërkombëtar për Ndërtimin e Anijeve që Transportojnë Kimikate të Rrezikshme në Sasi të Mëdha, të vitit 1983, të ndryshuar, si edhe produkte të rrezikshme për të cilat kushtet paraprake të përshtatshme të transportimit janë parashikuar tashmë nga administrata ose nga administratat portuale përkatëse, në përputhje me paragrafin 1.1.3 të Kodit;

iv) lëndët, materialet dhe artikujt e rrezikshëm, të pasigurta dhe të dëmshme në formë të paketuar që rregullohen nga Kodi Ndërkombëtar Detar për Mallrat e Rrezikshme, i ndryshuar;

v) gazet e kondensuara në formë të lëngshme siç janë renditur në kreun 19 të Kodit Ndërkombëtar për Ndërtimin e Anijeve që Transportojnë Gazra të Kondensuara në Gjendje të Lëngshme në Sasi të Mëdha, të vitit 1983, i ndryshuar, si dhe produkte për të cilat kushtet paraprake të përshtatshme të transportimit janë parashikuar tashmë nga administrata ose nga administratat portuale përkatëse, në përputhje me paragrafin 1.1.6 të Kodit;

vi) lëndë të lëngshme të transportuara në sasi të mëdha me një temperaturë ndezjeje që nuk i kalon 60 C (të matura sipas testit në enë të mbyllura);

vii) materiale të ngurta në sasi të mëdha që paraqesin rreziqe kimike që parashikohen nga Bashkëlidhja B e Kodit për Praktikën e Sigurta për Ngarkesat e Ngurta në Sasi të Mëdha, i ndryshuar, në shkallën që këto lëndë i nënshtrohen gjithashtu dispozitave të Kodit Ndërkombëtar Detar për Mallrat e Rrezikshme kur transportohen në formë të paketuar; dhe

b) mbetjet nga transportimet e mëparshme në sasi të mëdha të lëndëve të përmendura në paragrafët nga (a) (i) deri në (iii) dhe nga (v) deri në (vii) më lart.

6. “Dëm” nënkupton:

a) humbjen e jetës apo plagosjen vetjake në bord apo jashtë anijes që transporton lëndët e rrezikshme e helmuese, të shkaktuara nga këto lëndë;

b) humbjet apo dëmtimet ndaj pasurisë jashtë anijes që transporton lëndët e rrezikshme e helmuese, të shkaktuara nga këto lëndë;

c) humbjen apo dëmtimin për shkak të helmimit të mjedisit, të shkaktuar nga lëndët e rrezikshme dhe helmuese, me kusht që dëmshpërblimi për dëmet ndaj mjedisit i ndryshëm nga humbja e përfitimeve e shkaktuar nga këto dëme, të kufizohet në kostot e masave të arsyeshme që janë ndërmarre ose që do të ndërmerren për rivendosjen e tij; dhe

d) kostot e masave parandaluese dhe humbjet apo dëmtimet e mëtejshme të shkaktuara nga masat parandaluese.

Në rastet kur nuk është arsyeshmërisht e mundur që të veçohet dëmi i shkaktuar nga lëndët e rrezikshme dhe helmuese nga ai i shkaktuar nga faktorë të tjerë, do të quhet se të gjitha dëmet janë shkaktuar nga lëndët e rrezikshme dhe helmuese, përveç rasteve nëse, si dhe në masën që dëmi i shkaktuar nga faktorë të tjerë të jetë i llojit të përmendur në nenin 4, paragrafi 3.

Në këtë paragraf “shkaktuar nga këto lëndë” nënkupton shkaktuar nga natyra e rrezikshme ose helmuese e lëndëve.

7. “Masa parandaluese” nënkupton çfarëdo masash të arsyeshme të marra nga cilido person pasi ka ndodhur një incident për të parandaluar apo minimizuar dëmin.

8. “Incident” nënkupton çdo ngjarje apo vijimësi ngjarjesh që kanë të njëjtën prejardhje, e cila shkakton dëm nga ndotja apo krijon një kërcënim serioz dhe të menjëhershëm për të shkaktuar një dëm të tillë.

9. “Transportim përmes detit” nënkupton periudhën nga koha kur lëndët e rrezikshme dhe helmuese futen në çdo pjesë të pajisjeve të anijes, gjatë ngarkimit, deri në kohën që ato nuk janë më të pranishme në cilëndo pjesë të pajisjeve të anijes, gjatë shkarkimit. Nëse nuk përdoret asnjë pajisje e anijes, periudha fillon dhe mbaron përkatësisht kur lëndët e rrezikshme dhe helmuese kalojnë binarin e anijes.

10. “Ngarkesa shkaktuese” nënkupton çfarëdo lëndësh të rrezikshme dhe helmuese të cilat transportohen përmes detit si ngarkesë në drejtim të një porti apo terminali në territorin e një shteti palë dhe që shkarkohen në atë shtet. Ngarkesa në tranzit e cila transferohet drejtpërdrejt, ose përmes një porti ose terminali, nga një anije tek tjetra, qoftë plotësisht apo pjesërisht, gjatë transportit nga porti ose terminali i ngarkimit fillestar drejt portit ose terminalit të destinacionit përfundimtar do të quhet si ngarkesë shkaktuese vetëm në lidhje me marrjen në destinacionin përfundimtar.

11. “Fondi HNS” nënkupton Fondin Ndërkombëtar për Lëndët e Rrezikshme dhe Helmuese të ngritur sipas nenit 13.

12. “Njësia e llogarisë” nënkupton të Drejtën e Posaçme të Tërheqjes siç përcaktohet nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

13. “Shteti i regjistrimit të anijes” nënkupton, në lidhje me një anije të regjistruar, shtetin e regjistrimit të anijes dhe në lidhje me një anije të paregjistruar, shtetin, flamurin e të cilit anija ka të drejtë të mbajë.

14. “Terminal” nënkupton çfarëdo vendndodhje për ruajtjen e lëndëve të rrezikshme dhe helmuese të marra përmes transportimit ujor, duke përfshirë këtu edhe çdo shërbim të vendosur larg bregut e të lidhur me këtë vendndodhje përmes tubacioneve apo në mënyra të tjera.

15. “Drejtor” nënkupton Drejtorin e Fondit të HNS.

16. “Organizatë” nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare.

17. “Sekretar i Përgjithshëm” nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës.

SHTOJCAT

Neni 2

Shtojcat e kësaj Konvente janë pjesë përbërëse e saj.

Objekti i zbatimit

Neni 3

Kjo Konventë do të zbatohet ekskluzivisht:

- a) ndaj çdo dëmi të shkaktuar në territorin e një shteti palë, përfshirë këtu detin territorial;
- b) ndaj dëmeve që vijnë nga ndotja e mjedisit e shkaktuar në zonën ekskluzive ekonomike të një shteti palë, të përcaktuar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, ose nëse një shtet palë nuk e ka përcaktuar një zonë të tillë, në një zonë përtej dhe afër detit territorial të atij shteti të përcaktuar nga ai shtet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe që shtrihet jo më shumë se 200 milje detare nga vija bazë prej së cilës matet gjerësia e detit të tij territorial;
- c) ndaj dëmeve të ndryshme nga dëmet nga ndotja e mjedisit e shkaktuar jashtë territorit, përfshirë këtu edhe detin territorial, të cilin do shtet, nëse ky dëm është shkaktuar nga një lëndë e transportuar në bordin e anijes së regjistruar në një shtet palë ose, në rastin e një anijeje të paregjistruar, në bordin e një anijeje që ka të drejtë të mbajë flamurin e atij shteti palë; si dhe
- d) ndaj masave parandaluese kudo që të merren.

Neni 4

1. Kjo Konventë do të zbatohet për kërkesat, të ndryshme nga kërkesat që rrjedhin nga çfarëdo kontratë për transportimin e mallrave dhe të udhëtarëve, për dëme që rrjedhin nga transporti i lëndëve të rrezikshme dhe helmuese përmes detit.

2. Kjo Konventë nuk do të zbatohet në shkallën që dispozitat e saj janë në kundërshtim me ato të ligjeve të zbatueshme në lidhje me dëmshpërblimin e punonjësve apo me skemat e sigurimeve shoqërore.

3. Kjo Konventë nuk do të zbatohet:

a) për dëmet nga ndotja siç përcaktohen në Konventën Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë Civile për Dëmet nga Ndotja prej Karburanteve, e vitit 1969, e ndryshuar, pavarësisht nëse dëmshpërblimi në lidhje me të sipas asaj Konvente është i pagueshëm ose jo; dhe

b) për dëmet e shkaktuara nga një material radioaktiv i klasit 7 ose sipas Kodit Ndërkombëtar Detar të Mallrave të Rrezikshme siç ndryshuar, ose sipas bashkëlidhjes B të Kodit për Praktikën e Sigurta për Ngarkesat e Ngurta në Sasi të Mëdha, siç ndryshuar.

4. Përveçse siç parashikohet në paragrafin 5, dispozitat e kësaj Konvente nuk do të zbatohen ndaj anijeve të luftës, mjeteve ndihmëse detare apo anijeve të tjera që zotërohen apo operohen nga një shtet dhe që përdoren, për momentin, vetëm për veprimtari jotregtare qeveritare.

5. Një shtet palë mund të vendosë që ta zbatojë këtë Konventë edhe për anijet e tij të luftës apo për mjetet lundruese të përshkruara në paragrafin 4, rast në të cilin ai do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm përkatës duke përcaktuar me hollësi kushtet dhe afatet e një zbatimi të tillë.

6. Në lidhje me anijet që zotërohen nga një shtet palë dhe që përdoren për qëllime tregtare, secili shtet do t'u nënshtrohet padive në juridiksionet e përcaktuara në nenin 38 dhe do të heqë dorë nga çdo mbrojtje e bazuar në statusin e tij si shtet sovran.

Neni 5

1. Një shtet, në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, ose në çdo kohë të mëvonshme, mund të deklarojë se kjo Konventë nuk zbatohet për anijet:

- a) të cilat nuk kalojnë tonazhin 200 ton bruto; dhe
- b) të cilat transportojnë lëndë të rrezikshme dhe helmuese vetëm në formë të paketuar; dhe

- c) ndërsa ato janë të përfshira në udhëtime ndërmjet porteve apo mjediseve të atij shteti.
2. Kur dy shtetet fqinje bien dakord që kjo Konventë të mos zbatohet as për anije të cilat parashikohen në paragrafin 1 pikat (a) dhe (b) ndërsa janë të përfshira në udhëtime ndërmjet porteve ose mjediseve të atyre shteteve, shtetet e interesuara mund të deklarojnë që përjashtimi nga zbatimi i kësaj Konvente i shpallur sipas paragrafit 1, mbulon edhe anijet e referuara në këtë paragraf.
3. Cilido shtet i cili ka bërë një deklaram sipas paragrafit 1 ose 2 mund ta tërheqë këtë deklaram në çdo kohë.
4. Një deklaram i bërë sipas paragrafit 1 ose 2 dhe tërheqja e deklaramit e bërë sipas paragrafit 3, do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm i cili, pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, do t'ia komunikojë atë drejtorit.
5. Kur një shtet ka bërë një deklaram sipas paragrafit 1 ose 2 dhe nuk e ka tërhequr atë, lëndët e rrezikshme dhe helmuese që transportohen në bordin e anijeve të parashikuara nga ai paragraf, nuk do të quhet se janë ngarkesë shkaktuese për qëllimin e zbatimit të neneve 18, 20, nenit 21 paragrafi 5, si dhe nenit 43.
6. Fondi HNS nuk është përgjegjës që të paguajë dëmshpërblime për dëmet e shkaktuara nga lëndët e transportuara nga një anije ndaj të cilës nuk zbatohet Konventa në përputhje me një deklaram të bërë sipas paragrafit 1 ose 2, në masën që:
- a) dëmi, siç është përkufizuar në nenin 1, paragrafi 6, pikat (a), (b) ose (c), të jetë shkaktuar në:
 - i) territorin e një shteti, duke përfshirë detin territorial, i cili ka bërë deklaram ose, në rastin e Shteteve fqinje, të cilat kanë bërë një deklaram sipas paragrafit 2 të secilës prej tyre; ose
 - ii) zonën ekonomike ekskluzive, ose në zonën e përmendur në nenin 3 (b) të shtetit apo shteteve të referuara në pikën (i);
 - b) dëmi përfshin edhe masat e marra për të parandaluar apo pakësuar këtë dëm.

Detyrimet e shteteve palë

Neni 6

Secili shtet palë do të sigurojë që çdo detyrim që lind sipas kësaj Konvente të plotësohet dhe do të marrë masa të përshtatshme sipas legjislacionit të tij, duke përfshirë vendosjen e sanksioneve siç mund ta çmojë të arsyeshme, me qëllimin e zbatimit efikas të cilitdo detyrim të tillë.

KREU II PËRGJEGJËSIA

Përgjegjësia e pronarit të anijes

Neni 7

1. Përveçse siç parashikohet në paragrafët 2 dhe 3, pronari i anijes në kohën e një incidenti do të jetë përgjegjës për dëmin e ndotjes së shkaktuar nga çfarëdo lëndësh të rrezikshme dhe helmuese në lidhje me transportimin e tyre përmes detit në bordin e anijes, me kusht që, nëse një incident konsiston në një vijimësi ndodhish që kanë të njëjtën prejardhje, përgjegjësia do t'i atribuohet pronarit të anijes në kohën e ndodhisë së parë nga këto ndodhi.
2. Asnjë përgjegjësi nuk do t'i atribuohet pronarit të anijes për dëme të ndotjes nëse pronari i anijes provon që:
- a) dëmi ka ardhur si pasojë e një akti luftarake, e veprimeve luftarake, e luftës civile, kryengritjes apo një fenomeni natyror të një natyre të jashtëzakonshme, të pashmangshme e të papërballueshme;
 - b) dëmi ishte shkaktuar tërësisht nga një veprim apo mosveprim i bërë me qëllimin për të shkaktuar dëm, nga një palë e tretë; ose
 - c) dëmi ishte shkaktuar tërësisht nga neglizhenca apo veprime të tjera të gabuara të cilësdo qeveri apo autoriteti tjetër përgjegjës për mirëmbajtjen e ndriçimeve apo mjeteve të tjera ndihmëse të lundrimit në ushtrim të atij funksioni;

d) mosarritja e transportuesit ose e çdo personi tjetër që të japë informacione në lidhje me natyrën e rrezikshme dhe helmuese të lëndëve të transportuara ose

i) ka shkaktuar dëmin, tërësisht apo pjesërisht; ose

ii) ka bërë që pronari të mos përfitojë sigurim në përputhje me nenin 12;

me kusht që as pronari e as të punësuarit apo agjentët e tij të kenë ditur apo arsyeshmërisht të duhet të kenë ditur mbi natyrën e rrezikshme dhe helmuese të lëndëve të dërguara.

3. Nëse pronari i anijes provon se dëmi ka ardhur tërësisht apo pjesërisht qoftë nga një veprim apo mosveprim i bërë me qëllimin për të shkaktuar dëm nga personi që e ka pësuar këtë dëm apo nga neglizhenca e atij personi, pronari i anijes mund të çlirohet tërësisht apo pjesërisht nga përgjegjësia kundrejt këtij personi.

4. Asnjë pretendim për dëmshpërblim për dëm nuk do të ngrihet kundër pronarit të anijes në mënyrë të ndryshme nga sa është në përputhje me këtë Konventë.

5. Sipas paragrafit 6, asnjë pretendim për dëmshpërblim sipas kësaj Konvente ose tjetër nuk mund të ngrihet kundër:

a) të punësuarve apo agjentëve të pronarit apo anëtarëve të ekuipazhit;

b) pilotit apo cilitdo person tjetër i cili, pa qenë pjesë e ekuipazhit, kryen shërbime për anijen;

c) cilindo porosites (sido që të përshkruhet, duke përfshirë këtu edhe një porosites thjesht të anijes), administrator ose operues të anijes;

d) cilindo person që kryen operacione shpëtimi me pëlqimin e pronarit ose nën udhëzimet e një autoriteti kompetent publik;

e) cilindo person që merr masa parandaluese; dhe

f) të punësuarit ose agjentët e personave të përmendur në pikat (c), (d) dhe (e); përveçse kur është shkaktuar nga veprimet ose mosveprimet e vetë atyre, të kryera me qëllimin për ta shkaktuar këtë dëm ose nga pakujdesia dhe me dijeninë që një dëm i tillë kishte arsyeshmërisht shumë mundësi të shkaktohej.

6. Asgjë në këtë Konventë nuk do të cenojë çfarëdo të drejte për ankim të pronarit kundrejt cilësdo pale të tretë, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar tek transportuesi ose marrësi i lëndës që shkaktoi dëmin, ose personat që tregohen në paragrafin 5.

Incidente që përfshijnë dy ose më shumë anije

Neni 8

1. Kurdoherë që dëmi ka ardhur si pasojë e një incidenti që përfshin dy ose më shumë anije, secila prej të cilave transporton lëndë të rrezikshme dhe helmuese, secili pronar, përveçse kur është çliruar nga kjo sipas nenit 7, do të jetë përgjegjës për dëmet. Pronarët do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht për të gjitha këto dëme të cilat në mënyrë të arsyeshme nuk mund të ndahen.

2. Megjithatë, pronarët do të kenë të drejtë deri në kufijtë e përgjegjësisë të zbatueshme për secilin nga ata sipas nenit 9.

3. Asgjë në këtë nen nuk do të cenojë cilëndo të drejtë të një pronari për ankim kundër cilitdo pronar tjetër.

Kufizimi i përgjegjësisë

Neni 9

1. Pronari i një anijeje do të ketë të drejtë të kufizojë përgjegjësinë sipas kësaj Konvente në lidhje me cilindo incident në një shumë të llogaritur si vijon:

a) 10 milionë njësi të llogarisë për një anije që nuk i kalon 2000 njësitë e tonazhit; dhe

b) për një anije me tonazh më të madh se sa më sipër, shumën në vijim që i shtohet asaj të përmendur në pikën (a):

për çdo njësi tonazhi nga 2,001 deri në 50,000 njësi tonazhi – 1,500 njësi llogarie;

për çdo njësi tonazhi mbi 50,000 njësi tonazhi – 360 njësi llogarie;
me kusht që gjithsesi, kjo shumë e përgjithshme të mos kalojë në asnjë rast 100 milionë njësi të llogarisë.

2. Pronari nuk do të ketë të drejtë të kufizojë përgjegjësinë sipas kësaj Konvente nëse provohet se dëmi ka ardhur si rrjedhojë e veprimeve ose mosveprimeve personale të pronarit, të kryera me qëllimin për ta shkaktuar këtë dëm, ose nga pakujdesia si edhe me dijeninë që një dëm i tillë kishte arsyeshmërisht shumë mundësi të shkaktohej.

3. Pronari, me qëllim që të përfitojë nga kufizimi i parashikuar në paragrafin 1, do të ngrejë një fond aq sa shuma e përgjithshme që përfaqëson kufirin e përgjegjësisë që përcaktohet në përputhje me paragrafin 1 pranë gjykatës apo autoritetit tjetër kompetent të cilitdo nga shtetet palë në të cilin ngrihet pretendimi sipas nenit 38 ose, nëse asnjë pretendim nuk është ngritur, pranë cilësdo gjykatë apo autoritet tjetër kompetent në cilindo nga shtetet palë në të cilat mund të ngrihet një pretendim sipas nenit 38. Fondi mund të ngrihet ose duke depozituar shumën ose duke paraqitur një garanci bankare apo garanci tjetër, të pranueshme sipas legjislacionit të shtetit palë ku ngrihet fondi dhe që çmohet se është e përshtatshme nga gjykata apo nga autoriteti tjetër kompetent.

4. Në bazë të dispozitave të nenit 11, fondi do të shpërndahet mes pretenduesve në përpjesëtim me shumën e pretendimeve të tyre të vërtetuara.

5. Nëse përpara se të shpërndahet fondi, pronari ose cilido nga të punësuarit apo agjentët e tij apo cilido person që i ka dhënë pronarit garancinë apo çfarëdo garancie tjetër financiare, si rrjedhim i incidentit në fjalë, i ka paguar dëmshpërblimet për dëmet, ky person do të fitojë me zëvendësim të drejtat që personi i dëmshpërblyer në këtë mënyrë do të kishte gëzuar sipas kësaj konvente, deri në masën që ai ka paguar.

6. E drejta e zëvendësimit e parashikuar në paragrafin 5 mund të ushtrohet edhe nga një person i ndryshëm nga ata që përmenden në atë paragraf në lidhje me çfarëdo shume dëmshpërblimi për dëme të cilat ky person mund t'i ketë paguar, por vetëm deri në masën që një zëvendësim i tillë lejohet sipas legjislacionit të brendshëm të zbatueshëm.

7. Kur pronarët ose personat e tjerë përcaktojnë se ata mund të jenë të detyruar të paguajnë në një datë të mëvonshme tërësisht apo pjesërisht çfarëdo shume të tillë dëmshpërblimi, në lidhje me të cilën, nëse do të ishte paguar dëmshpërblimi përpara se fondi të lëvrohej, do të ishte gëzuar e drejta e zëvendësimit sipas paragrafëve 5 ose 6, gjykata ose autoriteti tjetër kompetent i shtetit ku është ngritur fondi mund të urdhërojë që një shumë e mjaftueshme të vihet mënjane provizorisht për të mundësuar këtë person në këtë datë të mëvonshme që të vërë në zbatim pretendimin e tij kundrejt fondit.

8. Pretendimet në lidhje me shpenzimet që janë shkaktuar në mënyrë të arsyeshme ose me përpjekjet që janë bërë në mënyrë të arsyeshme nga pronari me vullnetin e tij për të parandaluar apo pakësuar dëmin do të vlerësohen në mënyrë të barabartë me pretendimet e tjera të ngritura kundër fondit.

9. a) Shumat e përmendura në paragrafin 1 do të kthehen në monedhën e vendit mbi bazën e vlerës së asaj monedhe duke iu referuar të Drejtës së Posaçme për Tërheqje në datën e ngritjes së fondit të referuar në paragrafin 3. Vlera e monedhës vendase, sipas kuptimit të së Drejtës së Posaçme për Tërheqje për një shtet palë i cili është anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar, do të përlllogaritet në përputhje me metodën e vlerësimit të zbatuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar në fuqi në datën në fjalë për operacionet dhe transaksionet e tij. Vlera e monedhës vendase, në kuptimin e së Drejtës së Posaçme për tërheqje, për një shtet palë i cili nuk është anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar do të përlllogaritet në atë mënyrë që është përcaktuar nga ai shtet.

b) Megjithatë, një shtet palë i cili nuk është anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe ligjet e të cilit nuk lejohen zbatimin e dispozitave të paragrafit 9 (a) mundet që, në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë ose në çdo kohë të mëvonshme, të shpallë se njësisia e llogarisë të referuara në paragrafin 9 (a) do të jetë e barabartë me 15 franga ari. Franga e arit e referuar në këtë paragraf i korrespondon gjashtëdhjetë e pesë miligramëve e gjysmë flori në përqindjen nëntëqind për njëmijë. Kthimi i frangave të arit në monedhën vendase do të bëhet në përputhje me legjislacionin e shtetit të interesuar.

c) Përlllogaritja e përmendur në fjalinë e fundit të paragrafit 9 (a) dhe kthimi i përmendur në paragrafin 9 (b) do të bëhen në mënyrë të tillë që të shprehin në monedhën vendase të shtetit palë sa më shumë që të jetë e mundur të njëjtën vlerë reale për shumat në paragrafin 1, që do të rezultonte nga zbatimi i dy fjalive të para të paragrafit 9 (a). Shtetet palë do t'i komunikojnë Sekretarit të Përgjithshëm mënyrën e llogaritjes në përputhje me paragrafin 9 (a), ose rezultatit e kthimit sipas paragrafit 9 (b), sipas rastit, kur depozitojnë një instrument ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi në këtë Konventë dhe kurdoherë që ka një ndryshim në cilëndo prej tyre.

10. Për qëllimet e këtij neni, tonazhi i anijes do të jetë tonazhi bruto i llogaritur në përputhje me rregulloret për matjen e tonazhit të parashikuara në shtojcën I të Konventës Ndërkombëtare mbi Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969.

11. Siguruesi ose personi tjetër që jep garanci financiare do të ketë të drejtë të krijojë një fond në përputhje me këtë nen me të njëjtat kushte dhe që sjell të njëjtat pasoja sikur të ishte krijuar nga pronari. Një fond i tillë mund të krijohet edhe nëse, sipas dispozitave të paragrafit 2, pronari nuk ka të drejtë për kufizimin e përgjegjësisë, por krijimi i tij nuk do të cenojë në asnjë rast të drejtat e cilitdo pretendues kundrejt pronarit.

Neni 10

1. Kur pas një incidenti, pronari ka ngritur një fond në përputhje me nenin 9 dhe ka të drejtë për kufizimin e përgjegjësisë:

a) asnjë person që ngre një pretendim për dëme që rrjedhin nga incidenti nuk do të ketë të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj të drejte kundër çfarëdo pronash të pronarit në lidhje me këtë pretendim; dhe

b) gjykata apo autoriteti tjetër kompetent i cilitdo shtet palë do të urdhërojë lirim të cilësdo anije apo prone tjetër që i përket pronarit e cila është bllokuar në lidhje me një pretendim për dëme që rrjedhin nga ai incident dhe në mënyrë të ngjashme do të lirojë çfarëdo pengu apo sigurie tjetër të dhënë për të shmangur këtë bllokim.

2. Megjithatë, sa më sipër do të zbatohet vetëm nëse pretenduesi ka akses në gjykatën që administron fondin dhe nëse fondi është aktualisht i përdorshëm në lidhje me atë pretendim.

Vdekja dhe plagosja

Neni 11

Pretendimet në lidhje me vdekjen apo plagosjen vetjake do të kenë përparësi mbi pretendimet e tjera deri në masën që shumat e këtyre pretendimeve të mos kalojnë dy të tretat e shumës së përgjithshme të përcaktuar në përputhje me nenin 9, paragrafi 1.

Sigurimi i detyrueshëm i pronarit

Neni 12

1. Pronarit të një anijeje të regjistruar në një shtet palë dhe që aktualisht po transporton lëndë të rrezikshme dhe helmuese do t'i kërkohet që të mbajë një sigurim apo garanci tjetër financiare siç është një garanci bankare apo garanci e një institucioni tjetër financiar, në shumat e përcaktuara duke zbatuar kufijtë e përgjegjësisë të parashikuara në nenin 9, paragrafi 1, për të mbuluar përgjegjësinë për dëme sipas kësaj Konvente.

2. Një certifikatë e sigurimit të detyrueshëm që vërteton se ky sigurim apo kjo garanci tjetër financiare është në fuqi në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente do të lëshohet për çdo anije pasi autoriteti i duhur i një shteti palë të ketë përcaktuar se janë plotësuar kërkesat e paragrafit 1. Në lidhje me një anije të regjistruar në një shtet palë, kjo certifikatë e sigurimit të detyrueshëm do të lëshohet apo vërtetohet nga autoriteti i duhur i shteti të regjistrimit të anijes; në lidhje me një anije që nuk është e regjistruar në një shtet palë, ajo mund të lëshohet apo vërtetohet nga autoriteti i duhur i cilitdo shtet palë. Kjo certifikatë e detyrueshme e sigurimit do të jetë në formën e modelit të përcaktuar në shtojcën I dhe do të përmbajë veçoritë në vijim:

- a) emrin e anijes, numrat apo shkronjat dalluese dhe portin e regjistrimit;
- b) emrin dhe qendrën kryesore të punës së pronarit;
- c) numrin e identifikimit të anijes sipas IMO (Organizatës Ndërkombëtare Detare);
- d) tipin dhe kohëzgjatjen e sigurimit;
- e) emrin dhe qendrën kryesore të punës së siguresit apo të personit tjetër që jep garanci dhe kur është e përshtatshme, qendrën e punës ku është vendosur sigurimi ose garancia; dhe
- f) periudhën e vlefshmërisë së certifikatës e cila nuk do të jetë më e gjatë se sa periudha e vlefshmërisë së sigurimit ose e garancisë tjetër.

3. Certifikata e sigurimit të detyrueshëm do të jetë në gjuhën apo gjuhët zyrtare të shtetit që e lëshon. Nëse gjuha e përdorur nuk është as anglisht, as frëngjisht e as spanjisht, teksti do të përfshijë edhe një përkthim në një nga këto gjuhë.

4. Certifikata e sigurimit të detyrueshëm do të mbahet në bordin e anijes dhe një kopje do të depozitohet pranë autoriteteve të cilat mbajnë të dhënat për regjistrin e anijes ose nëse anija nuk është e regjistruar në atë shtet palë, pranë autoritetit të shtetit që e lëshon apo e vërteton certifikatën.

5. Një sigurim apo garanci tjetër financiare nuk do të përmbushë kërkesat e këtij neni nëse ajo ndërpritet, për arsye të ndryshme nga mbarimi i periudhës së vlefshmërisë së sigurimit apo garancisë së përcaktuar në certifikatë sipas paragrafit 2, më parë se të kenë kaluar tre muaj nga data në të cilën jepet njoftimi për mbarimin e saj ndaj autoriteteve të referuara në paragrafin 4, përveçse kur certifikata e sigurimit të detyrueshëm (u është dorëzuar autoriteteve ose një certifikatë e re)* është lëshuar brenda periudhës së përmendur më lart. Dispozitat e mësipërme do të zbatohen në mënyrë të ngjashme për çdo ndryshim që shkakton që sigurimi apo garancia të mos përmbushë më kërkesat e këtij neni.

* Fjalët në kllapa gabimisht nuk janë përfshirë në tekstin origjinal; shih LEG 74/13 paragrafi 59 e në vijim.

6. Shteti i regjistrimit të anijes, në përputhje me dispozitat e këtij neni, do të përcaktojë kushtet e lëshimit dhe vlefshmërinë e certifikatës së sigurimit të detyrueshëm.

7. Certifikatat e sigurimit të detyrueshëm, të lëshuara apo të vërtetuara nën autoritetin e një shteti palë në përputhje me paragrafin 2, do të pranohen nga shtetet e tjera palë për qëllimet e kësaj Konvente dhe do të quhen nga shtetet e tjera palë sikur të kenë të njëjtën fuqi si certifikatat e sigurimit të detyrueshëm të lëshuara apo të vërtetuara nga vetë ato edhe nëse janë të lëshuara apo të vërtetuara në lidhje me një anije që nuk është e regjistruar në një shtet palë. Një shtet palë mundet që në çdo kohë të kërkojë këshillim me shtetin lëshues apo vërtetues nëse beson se siguresi apo garantuesi i përmendur në certifikatën e sigurimit të detyrueshëm nuk është i aftë financiarisht që të përmbushë detyrimet e vendosura nga kjo Konventë.

8. Çfarëdo pretendimi për dëmshpërblim për dëme mund të ngrihet drejtpërdrejt kundër siguresit ose personit tjetër që jep garanci financiare për përgjegjësinë e pronarit për dëmet. Në këtë rast, i padituri mund të përfitojë nga kufizimi i përgjegjësisë edhe nëse pronari nuk ka të drejtë të përfitojë nga kufizimi i përgjegjësisë, kufizim i parashikuar në përputhje me paragrafin 1. I padituri mund të përfitojë gjithashtu nga ndihma e atyre mjeteve (të ndryshme nga falimentimi apo likuidimi i pronarit) prej të cilave edhe pronari do të kishte pasur të drejtë të përfitonte. Për më tepër, i padituri mund të përfitojë nga mbrojtja për arsye se dëmi ka ardhur nga sjellja e keqe e vullnetshme e pronarit, por i padituri nuk mund të përfitojë më nga asnjë mjet tjetër mbrojtës nga i cili mund të kishte pasur të drejtë të përfitonte pronari në procedimet e ngritura nga vetë pronari kundër të paditurit. Në çdo rast, i padituri do të ketë të drejtë të kërkojë nga pronari që t'i bashkohet atij në këto procedime.

9. Çfarëdo shume e vendosur nga sigurimi apo garancia tjetër financiare në përputhje me paragrafin 1, do të jetë e përdorshme ekskluzivisht për përmbushjen e pretendimeve sipas kësaj Konvente.

10. Një shtet palë nuk do të lejojë një anije që mban flamurin e tij e ndaj së cilës zbatohet kjo Konventë që të operojë në mënyrë tregtare derisa të lëshohet një certifikatë sipas paragrafit 2 ose atij 12.

11. Sipas dispozitave të këtij neni, secili shtet palë do të sigurojë, sipas legjislacionit të tij, që sigurimi apo garancia tjetër në shumat e përcaktuara në paragrafin 1 të jenë në fuqi në lidhje me

cilëndo anije, kudo qoftë e regjistruar, që hyn apo largohet nga një port në territorin e tij, apo që mbërrin në apo largohet nga një mjedis larg bregut në detin e tij territorial.

12. Nëse sigurimi apo garancia tjetër financiare nuk ruhet në lidhje me një anije të zotëruar nga një shtet palë, dispozitat e këtij neni që lidhen me të nuk do të jenë të zbatueshme për këtë anije, por anija do të mbajë një certifikatë të sigurimit të detyrueshëm të lëshuar nga autoritetet e duhura të shtetit të regjistrimit të anijes ku deklarohet se anija zotërohet nga ai shtet dhe se përgjegjësia e anijes mbulohet brenda kufirit të parashikuar në përputhje me paragrafin 1. Kjo certifikatë e sigurimit të detyrueshëm do të ndjekë sa më shumë që të jetë e mundur modelin e parashikuar nga paragrafi 2.

KREU III DËMSHPËRBLIMI NGA FONDI NDËRKOMBËTAR PËR LËNDËT E RREZIKSHME DHE HELMUESE (FONDI HNS)

Krijimi i Fondit HNS

Neni 13

1. Fondi Ndërkombëtar për Lëndët e Rrezikshme dhe Helmuese (Fondi HNS) krijohet me qëllimet e mëposhtme:

a) të sigurojë dëmshpërblim për dëmet në lidhje me transportimin e lëndëve të rrezikshme dhe helmuese përmes detit, për aq sa mbrojtja që jepet në kreun II të jetë e papërshtatshme apo e padisponueshme; dhe

b) për t'u dhënë fuqi detyrave që lidhen me të siç përcaktohen në nenin 15.

2. Fondi HNS do të njihet në secilin shtet palë si person juridik sipas legjislacionit të atij shteti, i aftë për të marrë përsipër të drejta dhe detyrime, si dhe për të qenë palë në procedime ligjore pranë gjykatave të atij shteti. Secili shtet palë do ta njohë drejtorin si përfaqësuesin ligjor të Fondit HNS.

Dëmshpërblimi

Neni 14

1. Për qëllime të plotësimit të funksioneve të tij sipas nenit 13 paragrafi 1 (a), Fondi HNS do të paguajë dëmshpërblim për cilindo person që ka pësuar dëme, nëse ky person nuk ka mundur që të përftojë dëmshpërblim të plotë dhe të përshtatshëm sipas termave të kreut II:

a) sepse nuk përcaktohet asnjë përgjegjësi për dëmet sipas kreut II;

b) sepse pronari përgjegjës për dëmet sipas kreut II është i paaftë financiarisht të përmbushë plotësisht detyrimet sipas kësaj Konvente dhe çfarëdo sigurimi financiar që mund të jetë vendosur sipas kreut II nuk mbulon apo është i pamjaftueshëm për t'i përmbushur pretendimet për dëmshpërblim apo dëm; një pronar trajtohet si financiarisht i paaftë që t'i përmbushë këto detyrime dhe një garanci financiare trajtohet si e pamjaftueshme nëse personi që ka pësuar dëme e ka pasur të pamundur të përftojë një përmbushje të plotë të shumës së dëmshpërblimit të duhur sipas kreut II pasi ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të ndjekur mjetet e përdorshme ligjore;

c) sepse dëmi tejkalon përgjegjësinë e pronarit sipas termave të kreut II.

2. Shpenzimet që i janë shkaktuar në mënyrë të arsyeshme pronarit apo përpjekjet e bëra nga pronari në mënyrë të arsyeshme me vullnetin e tij për të parandaluar apo pakësuar dëmin do të trajtohen si dëm për qëllime të këtij neni.

3. Fondi HNS do të çmojë se nuk ka asnjë detyrim sipas paragrafëve paraardhës nëse:

a) ai provon se dëmi ka ardhur si pasojë e një akti lufte, e veprimeve luftarake, e luftës civile apo kryengritjes ose se dëmi u shkaktua nga lëndë të rrezikshme dhe helmuese, të cilat kanë rrjedhur apo janë shkarkuar nga një anije lufte ose nga një anije tjetër e zotëruar ose e vënë në veprim nga një shtet dhe e përdorur, për kohën e incidentit, vetëm për shërbime jotregtare qeveritare; ose

b) pretenduesi nuk mund të provojë se ka një mundësi të arsyeshme që dëmi të jetë shkaktuar si pasojë e një incidenti që ka përfshirë një ose më shumë anije.

4. Nëse Fondi HNS provon se dëmi ka ardhur plotësisht apo pjesërisht nga një veprim ose mosveprim i bërë me qëllimin për të shkaktuar dëm nga personi i cili e ka pësuar dëmin ose nga neglizhenca e atij personi, Fondi HNS mund të çlirohet tërësisht apo pjesërisht nga detyrimi i tij për t'i paguar këtij personi dëmshpërblim. Fondi HNS në çdo rast do të çlirohet në atë masë që pronari mund të jetë çliruar sipas nenit 7, paragrafi 3. Megjithatë, nuk do të ketë asnjë lehtësim të tillë të Fondit HNS në lidhje me masat parandaluese.

5. a) Përveçse kur parashikohet ndryshe në nënparagrafin (b), shuma e përgjithshme e dëmshpërblimit e pagueshme nga Fondi HNS sipas këtij neni në lidhje me çfarëdolloj incidenti do të jetë e kufizuar, në mënyrë që vlera e përgjithshme e asaj shume dhe cilado shumë e paguar sipas kreut II për dëme brenda qëllimit të zbatimit të kësaj konvente, siç përcaktohet në nenin 3, të mos kalojë 250 milionë njësi të llogarisë.

b) Shuma përmbledhëse e dëmshpërblimit të pagueshëm nga Fondi HNS sipas këtij neni për dëme që kanë ardhur si pasojë e një fenomeni natyror të një natyre të jashtëzakonshme, të pashmangshëm dhe të pazëzueshëm nuk do të kalojë 250 milionë njësi të llogarisë.

c) Interesi i akumuluar mbi një fond të krijuar në përputhje me nenin 9, paragrafi 3, nëse ka një interes të tillë, nuk do të merret parasysh për llogaritjen e dëmshpërblimit maksimal të pagueshëm nga Fondi HNS sipas këtij neni.

d) Shumat e përmendura në këtë nen do të kthehen në monedhën e vendit mbi bazën e vlerës së asaj monedhe duke iu referuar të Drejtës së Posaçme për Tërheqje në datën e vendimit të Asamblesë së Fondit HNS për sa i përket datës së parë të pagesës së dëmshpërblimit.

6. Kur shuma e pretendimeve të përcaktuara kundër Fondit HNS tejkalon shumën përmbledhëse të dëmshpërblimit të pagueshëm sipas paragrafit 5, shuma e disponueshme do të shpërndahet në një mënyrë të tillë që përpjesëtimi ndërmjet cilitdo pretendim të përcaktuar dhe shumës së dëmshpërblimit të marrë aktualisht nga pretenduesi sipas kësaj Konvente të jetë e njëjtë për të gjithë pretenduesit.

Pretendimet në lidhje me vdekjen apo plagosjen vetjake do të kenë përparësi mbi pretendimet e tjera deri në masën që shuma e këtyre pretendimeve të mos kalojë dy të tretat e shumës së përgjithshme të përcaktuar në përputhje me nenin paragrafin 5.

7. Asambleja e fondit HNS mund të vendosë që, në raste përjashtimore, dëmshpërblimi në përputhje me këtë Konventë mund të paguhet edhe nëse pronari nuk ka ngritur një fond në përputhje me kreun II. Në këto raste zbatohet paragrafi 5 (d).

Detyra që lidhen me Fondin HNS

Neni 15

Për qëllime të përmbushjes së funksioneve të tij sipas nenit 13, paragrafi 1 (a), Fondi HNS do të ketë këto detyra:

a) Të shqyrtojë pretendimet e bëra kundër Fondit HNS;

b) Të përgatisë një vlerësim në formën e një buxheti për çdo vit kalendarik për:

Shpenzimet:

i) kostot dhe shpenzimet e administratës së Fondit të HNS në vitin përkatës dhe çdo deficit nga operacionet në vitet paraardhëse; dhe

ii) pagesat që duhen bërë nga Fondi i HNS në vitin përkatës.

Të ardhurat:

iii) fondet tepriçë nga operacionet në vitet paraardhëse duke përfshirë edhe çdo interes;

iv) kontributet fillestare që duhen paguar gjatë vitit;

v) kontributet vjetore nëse kërkohet për të baraspeshuar buxhetin; dhe

vi) çfarëdolloj të ardhure tjetër.

c) Të përdorë, sipas kërkesës së një shteti palë, shërbimet e tij të përshtatshme, sipas nevojës, që të ndihmojë atë shtet për të siguruar menjëherë personelin, materialet dhe shërbimet që janë të nevojshme për të mundësuar shtetin të marrë masa për të parandaluar apo pakësuar dëmin që vjen si pasojë e një incidenti në lidhje me të cilin mund të thirret në veprim Fondi HNS për të paguar dëmshpërblim sipas kësaj Konvente; dhe

d) Të sigurojë, sipas kushteve të përcaktuara në rregulloret e brendshme, lehtësitë për kreditim për qëllimin e marrjes së masave parandaluese ndaj dëmeve që rrjedhin nga një incident i caktuar në lidhje me të cilin mund të kërkohet Fondi HNS për të paguar dëmshpërblim sipas kësaj Konvente.

Dispozita të përgjithshme mbi kontributet

Neni 16

1. Fondi HNS do të ketë një llogari të përgjithshme e cila do të ndahet në sektorë.
2. Fondi HNS, sipas nenit 19, paragrafëve 3 dhe 4, do të ketë gjithashtu llogari të veçanta në lidhje me:
 - a) karburantet që përkufizohen në nenin 1, paragrafi 5 (a) (i) (llogaria për karburantet);
 - b) gazrat natyrore të kthyer në formë të lëngshme të hidrokarbureve të lehta që kanë metanin si përbërës kryesor (LNG) (llogaria për LNG); dhe
 - c) gazrat e naftës (me origjinë nga nafta) të kthyer në gjendje të lëngshme të hidrokarbureve të lehta që kanë propanin dhe butanin si përbërës kryesorë (LPG) (llogaria për LPG).
3. Do të ketë kontribute fillestare dhe si të kërkohet, edhe kontribute vjetore për Fondin e HNS.
4. Kontributet për Fondin e HNS do të bëhen në llogarinë e përgjithshme në përputhje me nenin 19 dhe/ose në llogarinë e përgjithshme ose në llogaritë e veçanta në përputhje me nenin 20 ose nenin 21, paragrafi 5. Sipas nenit 19, paragrafi 6, llogaria e përgjithshme do të jetë e disponueshme për të dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar nga lëndët e rrezikshme dhe helmuese të mbuluara nga ajo llogari dhe një llogari e veçantë do të jetë e disponueshme për të dëmshpërblyer dëmin e shkaktuar nga lëndët e rrezikshme dhe helmuese që mbulohen nga kjo llogari.
5. Për qëllimet e neneve 18 dhe 19, paragrafi 1 (a) (i), paragrafi 1 (a) (ii) dhe paragrafi 1 (c), neneve 20 dhe 21, paragrafi 5, kur sasia e një tipi të caktuar të dhënë ngarkese shkaktuese të marrë në territorin e një shteti palë nga cilido person në një vit kalendarik mblidhet me sasi të njëjtës lloj ngarkese të marrë në të njëjtin shtet palë në atë vit nga cilido apo cilitdo persona të asociuar me të dhe tejkalon kufirin e përcaktuar në nënparagrafët përkatës, ky person do të paguajë kontributet në lidhje me sasinë aktuale të marrë nga ai person, pavarësisht se ajo sasi nuk kalon kufirin përkatës.
6. “Person i asociuar” nënkupton cilindo entitet të varur apo zakonisht të kontrolluar. Çështja nëse një person bëhet pjesë e këtij përkufizimi do të përcaktohet nga legjislacioni i brendshëm i shtetit të interesuar.

Dispozita të përgjithshme mbi kontributet vjetore

Neni 17

1. Kontributet vjetore në llogarinë e përgjithshme dhe në secilën llogari të veçantë do të caktohen vetëm siç kërkohet për të bërë pagesa nga llogaria në fjalë.
2. Kontributet vjetore të pagueshme në pajtim me nenet 18, 19 dhe 21, paragrafi 5, do të përcaktohen nga Asambleja dhe do të përlllogariten në përputhje me ato nene mbi bazën e njësisive të ngarkesës shkaktuese të marrë ose, në lidhje me ngarkesat e referuara në nenin 19, paragrafi 1 (b), të shkarkuar gjatë vitit kalendarik paraardhës ose në cilindo vit tjetër që Asambleja mund të vendosë.
3. Asambleja do të vendosë shumën e përgjithshme të kontributeve vjetore që do të vendosen për t'u derdhur në llogarinë e përgjithshme dhe në secilën llogari të veçantë. Në vijim të atij vendimi drejtori, në lidhje me secilin shtet palë, do të përlllogarisë për secilin person përgjegjës që të paguajë kontribute në përputhje me nenet 18, 19 paragrafi 1, dhe nenin 21, paragrafi 5, shumën e kontributit vjetor të atij personi në secilën llogari, mbi bazën e një shume fikse për çdo njësi të ngarkesës shkaktuese të raportuar në lidhje me personin gjatë vitit paraardhës kalendarik ose cilitdo vit tjetër që Asambleja mund të vendosë. Për llogarinë e përgjithshme, shumat fikse e 5006

sipërpërmendur për njësi të ngarkesës shkaktuese për secilin sektor do të përllogaritet në përputhje me rregullat që përmbahen në shtojcën II të kësaj Konvente. Për çdo llogari të veçantë, shuma fikse për njësi të ngarkesës shkaktuese e përmendur më lart do të përllogaritet duke pjesëtuar kontributin e përgjithshëm vjetor që duhet të vendoset në atë llogari me sasinë e përgjithshme të ngarkesës që kontribuon në atë llogari.

4. Asambleja gjithashtu mund të vendosë kontribute vjetore për kostot administrative dhe të vendosë për shpërndarjen e këtyre kostove ndërmjet sektorëve të llogarisë së përgjithshme dhe llogarive të veçanta.

5. Asambleja do të vendosë gjithashtu mbi shpërndarjen ndërmjet llogarive dhe sektorëve përkatës të shumave të paguara për dëmshpërblim për dëmet e shkaktuara nga dy ose më shumë lëndë të cilat u përkasin llogarive ose sektorëve të ndryshëm, mbi bazën e një vlerësimi të masës në të cilën secila nga lëndët ka kontribuar për këtë dëm.

Kontributet vjetore në llogarinë e përgjithshme

Neni 18

1. Sipas nenit 16, paragrafi 5, kontributet vjetore në llogarinë e përgjithshme do të bëhen në lidhje me secilin shtet palë nga cilido person i cili ishte marrësi në atë shtet në vitin paraardhës kalendarik ose në cilindo vit tjetër që Asambleja mund të vendosë, i sasive përmbledhëse që tejkalojnë 20 000 tonë ngarkesë shkaktuese, të ndryshme nga lëndët e përmendura në nenin 19, paragrafi 1, të cilat janë brenda sektorëve në vijim:

- a) materiale të ngurta në sasi të mëdha të referuara në nenin 1, paragrafi 5 (a) (vii);
- b) lëndët e referuara në paragrafin 2; dhe
- c) lëndë të tjera.

2. Kontributet vjetore do të jenë gjithashtu të pagueshme në llogarinë e përgjithshme nga persona të cilët do të ishin përgjegjës për të paguar kontribute në një llogari të posaçme në përputhje me nenin 19, paragrafi 1, nëse operimi i saj nuk do të ishte shtyrë apo pezulluar në përputhje me nenin 19. Secila llogari e veçantë, operimi i së cilës është shtyrë apo pezulluar sipas nenit 19, do të formojë një sektor të veçantë brenda llogarisë së përgjithshme.

Kontributet vjetore në llogaritë e veçanta

Neni 19

1. Sipas nenit 16, paragrafi 5, kontributet vjetore në llogaritë e veçanta do të bëhen në lidhje me secilin shtet palë:

- a) në rastin e një llogarie për karburantet:

- i) nga cilido person, i cili në atë shtet ka marrë në vitin kalendarik paraardhës ose në cilindo vit tjetër që Asambleja mund të vendosë, sasi të përgjithshme që tejkalojnë 150 000 tonë të karburanteve kontribuese që përcaktohen në nenin 1, paragrafi 3 të Konventës Ndërkombëtare për Krijimin e një Fondi Ndërkombëtar për Dëmshpërblimin për Dëmet e Shkaktuara nga Ndotja për shkak të Karburanteve, e vitit 1971, e ndryshuar, e që është apo do të ishte përgjegjës për të paguar kontribute ndaj Fondit Ndërkombëtar për Dëmshpërblimet për Ndotjen për shkak të Karburanteve, në përputhje me nenin 10 të asaj Konvente; dhe

- ii) nga cilido person i cili ishte marrësi në atë shtet në vitin kalendarik paraardhës ose në cilindo vit tjetër që Asambleja mund të vendosë, sasi të përgjithshme që tejkalojnë 20 000 tonë të karburanteve të tjera që transportohen në sasi të mëdha që renditen në bashkëlidhjen I të shtojcës I të Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, të vitit 1973, e ndryshuar nga Protokollin i vitit 1978 në lidhje me të, i ndryshuar.

- b) Në rastin e një llogarie për LNG, nga cilido person i cili në vitin kalendarik paraardhës ose në cilindo vit tjetër që Asambleja mund të vendosë, ishte titullar i të drejtave mbi një ngarkesë LNG të shkarkuar në një port apo terminal të atij shteti.

c) Në rastin e një llogarie për LPG, nga cilido person i cili në vitin kalendarik paraardhës ose në cilindo vit tjetër që Asambleja mund të vendosë, ishte marrësi në atë shtet i sasive të përgjithshme që tejkalojnë 20 000 tonë LPG.

2. Sipas paragrafit 3, llogaritë e veçanta të referuara në paragrafin 1 më lart do të hyjnë në fuqi në të njëjtën kohë me llogarinë e përgjithshme.

3. Operimi fillestar i një llogarie të veçantë të referuar në nenin 16, paragrafi 2 do të shtyhet deri në kohën që sasitë e ngarkesës shkaktuese në lidhje me atë llogari gjatë vitit kalendarik paraardhës ose cilido vit tjetër që Asambleja mund të vendosë, tejkalojnë nivelet e mëposhtme:

a) 350 milionë tonë ngarkesë shkaktuese në lidhje me llogarinë e karburanteve;

b) 20 milionë tonë ngarkesë shkaktuese në lidhje me llogarinë LNG;

c) 15 milionë tonë ngarkesë shkaktuese në lidhje me llogarinë LPG;

4. Asambleja mund të pezullojë operimin e një llogarie të veçantë nëse:

a) sasitë e ngarkesës shkaktuese në lidhje me atë llogari gjatë vitit kalendarik paraardhës bien nën nivelin përkatës të përcaktuar në paragrafin 3; ose

b) kur kanë kaluar gjashtë muaj nga data kur duheshin lëvruar kontributet dhe gjithë kontributet e papaguara ndaj asaj llogarie tejkalojnë dhjetë për qind të shumës më të fundme të vendosur për atë llogari në përputhje me paragrafin 1.

5. Asambleja mund të rifillojë operimin e një llogarie të veçantë e cila ishte pezulluar në përputhje me paragrafin 4.

6. Cilido person që do të ishte përgjegjës për të paguar kontribute për një llogari të veçantë, operimi i së cilës është shtyrë në përputhje me paragrafin 3 ose pezulluar në përputhje me paragrafin 4, do të paguajë në llogarinë e përgjithshme kontributet që ai person duhet të paguante në lidhje me atë llogari të veçantë. Për qëllimin e llogaritjes së kontributeve të ardhshme llogaria e veçantë e shtyrë ose e pezulluar do të formojë një sektor të ri në llogarinë e përgjithshme dhe do t'i nënshtrohet sistemit të pikëve HNS të përcaktuara në shtojcën II.

Kontributet fillestare

Neni 20

1. Në lidhje me secilin shtet palë, kontributet fillestare do të jepen në një shumë e cila për çdo person përgjegjës për të paguar kontribute në përputhje me nenin 16, paragrafi 5, nenet 18, 19 dhe 21, paragrafi 5, do të përlllogaritet mbi bazën e një vlere fikse, të barabartë për llogarinë e përgjithshme dhe secilën llogari të veçantë, për çdo njësi të ngarkesës shkaktuese të marrë ose në rastin e LNG, të shkarkuar në atë shtet gjatë vitit kalendarik që i paraprin atij në të cilin kjo Konventë hyn në fuqi në atë shtet.

2. Vlera fikse dhe njësitë për sektorët e ndryshëm brenda llogarisë së përgjithshme, si edhe për çdo llogari të veçantë të referuar në paragrafin 1, do të përcaktohen nga Asambleja.

3. Kontributet fillestare do të paguhen brenda tre muajve nga data në të cilën Fondi HNS lëshon fatura në lidhje me secilin shtet palë për personat përgjegjës për të paguar kontribute në përputhje me paragrafin 1.

Raportet

Neni 21

1. Secili shtet palë do të sigurojë që cilido person përgjegjës për të paguar kontribute në përputhje me nenet 18 e 19 ose me paragrafin 5 të këtij neni të jetë i regjistruar në një listë e cila do të hartohet dhe përditësohet nga drejtori në përputhje me dispozitat e këtij neni.

2. Për qëllimet e përcaktuara në paragrafin 1, secili shtet palë do t'i komunikojë drejtorit, në kohën dhe mënyrën që do të parashikohet në rregulloret e brendshme në Fondit HNS, emrin dhe adresën e cilitdo person i cili, në lidhje me atë shtet, është përgjegjës për të paguar kontribute në përputhje me nenet 18 e 19 ose me paragrafin 5 të këtij neni, si dhe të dhëna mbi sasitë përkatëse të ngarkesave shkaktuese për të cilat ky person është përgjegjës të kontribuojë në lidhje me vitin kalendarik paraardhës.

3. Për qëllime të konstatimit se kush janë, në çdo kohë të caktuar, personat përgjegjës për të paguar kontribute në përputhje me nenet 18 e 19 ose me paragrafin 5 të këtij neni, si dhe të përcaktimit, kur është e zbatueshme, të sasive të ngarkesës që duhen mbajtur parasysh kur përcaktohen shumat e kontributit, lista do të jetë provë *prima facie* për faktet që ajo përmban.

4. Kur një shtet palë nuk përmbush detyrimet e tij për t'i komunikuar drejtorit informacionin e referuar në paragrafin 2 dhe kjo sjell si pasojë humbje financiare për Fondin e HNS ai shtet palë do të jetë përgjegjës për të dëmshpërblyer Fondin HNS për këtë humbje. Asambleja, mbi bazën e rekomandimit të drejtorit, do të vendosë nëse ky dëmshpërblim do të bëhet i pagueshëm nga një shtet palë.

5. Në lidhje me ngarkesën shkaktuese të transportuar nga një port ose terminal i një shteti palë drejt një porti ose terminali tjetër në të njëjtin shtet dhe të shkarkuar atje, shtetet palë do të kenë mundësinë e paraqitjes pranë Fondit HNS një raport me sasinë përmbledhëse vjetore për secilën llogari që mbulon të gjitha marrjet e ngarkesave shkaktuese, përfshirë këtu çfarëdo sasish në lidhje me të cilat janë të pagueshme kontributet në përputhje me nenin 16, paragrafi 5. Në kohën e raportimit, shteti palë:

a) ose do të njoftojë Fondin HNS se ai shtet do të paguajë shumën përmbledhëse për çdo llogari në lidhje me vitin përkatës në një pagesë të vetme në favor të Fondit HNS;

b) ose do të udhëzojë Fondin HNS për të përcaktuar dhe vendosur shumën përmbledhëse për secilën llogari duke faturuar marrësit individualë ose në rastin e LNG, titullarin e të drejtave i cili shkarkon brenda juridiksionit të atij shteti, për shumën e pagueshme nga secili prej tyre. Këta persona do të identifikohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm të shtetit të interesuar.

Mospagimi i kontributeve

Neni 22

1. Shuma e çfarëdo kontributi që duhet të jepet sipas neneve 18, 19 e 20 ose nenit 21, paragrafi 5, e që në vonesë do të ketë interes në një normë interesi që do të përcaktohet në përputhje me rregulloret e brendshme të Fondit HNS, me kusht që të mund të caktohen norma të ndryshme për rrethana të ndryshme. Kur një person që është përgjegjës për të paguar kontribute në përputhje me nenet 18, 19 e 20 ose nenin 21, paragrafi 5, nuk përmbush detyrimet në lidhje me cilindo kontribut ose pjesë të tij dhe është në vonesë, drejtori do të ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura, përfshirë edhe ngritjen e pretendimeve në gjykatë, kundër këtij personi në emër të Fondit HNS me synimin e kompensimit të shumës së duhur. Megjithatë në rastet kur kontribuesi i paaftë është haptazi në gjendje insolvabël, ose rrethanat e kërkojnë këtë në mënyrë tjetër, Asambleja, bazuar në rekomandimin e drejtorit, mund të vendosë që të mos ndërmerret apo vazhdohet asnjë veprim kundrejt kontribuesit.

Përgjegjësia fakultative e shteteve palë për pagesën e kontributeve

Neni 23

1. Pa cenuar nenin 21, paragrafi 5, një shtet palë, në kohën kur depoziton instrumentin e tij të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në Konventë apo në çdo kohë të mëvonshme, do të deklarojë se merr përsipër përgjegjësinë për detyrimet e vendosura nga kjo Konventë mbi cilindo person përgjegjës për të paguar kontribute në përputhje me nenet 18, 19 e 20 ose nenin 21, paragrafi 5 në lidhje me lëndët e rrezikshme dhe helmuese të marra apo të shkarkuara në territorin e atij shteti. Kjo deklaratë do të bëhet me shkrim dhe do të përcaktojë se cilat detyrime merren përsipër.

2. Kur është bërë një deklaratë sipas paragrafit 1 përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente në përputhje me nenin 46, ajo do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm i cili, pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, ia komunikon deklaratën drejtorit.

3. Deklarata sipas paragrafit 1 që është bërë pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente do të depozitohet pranë drejtorit.

4. Një deklaratë e bërë në përputhje me këtë nen mund të tërhiqet nga shteti përkatës duke njoftuar drejtorin me shkrim për këtë. Ky njoftim do të hyjë në fuqi tre muaj pas marrjes së njoftimit përkatës nga drejtori.

5. Cilido shtet që ka detyrime si rrjedhim i një deklarate të bërë sipas këtij neni do të heqë dorë nga çfarëdo lloji imuniteti që në rast tjetër do të kishte të drejtë të pretendonte në çfarëdo procedimesh që ngrihen kundër tij para një gjykate kompetente në lidhje me çdo detyrim të përcaktuar në deklaratë.

Organizimi dhe administrata

Neni 24

Fondit HNS do të ketë një Asamble dhe Sekretariat të drejtuar nga drejtori.

Asambleja

Neni 25

Asambleja do të përbëhet nga të gjitha shtetet palë në këtë Konventë.

Neni 26

Funksionet e Asamblesë do të jenë si vijon:

a) të zgjedhë në secilin sesion të zakonshëm presidentin e saj dhe dy zëvendës-presidentë të cilët do të qëndrojnë në detyrë deri në sesionin tjetër të zakonshëm;

b) të përcaktojnë rregullat e veta të procedurës, në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente;

c) të zhvillojnë, zbatojnë dhe mbikëqyrin rregullat e brendshme dhe ato financiare në lidhje me qëllimin e Fondit HNS, siç përshkruhen në nenin 13, paragrafi 1 (a) dhe detyrat përkatëse të Fondit HNS të renditura në nenin 15;

d) të emërojnë drejtorin dhe të hartojnë dispozita për emërimin e personelit tjetër që mund të jetë i nevojshëm, si dhe të përcaktojnë termat dhe kushtet e shërbimit të drejtorit dhe personelit tjetër;

e) të miratojnë buxhetin vjetor të përgatitur në përputhje me nenin 15 (b);

f) të marrë në shqyrtim dhe të miratojnë si të jetë e nevojshme çdo rekomandim të drejtorit në lidhje me qëllimin e përkufizimit të ngarkesës shkaktuese;

g) të emërojnë kontrollorët financiarë dhe të miratojnë bilanci të Fondit të HNS;

h) të miratojnë zgjidhjen e pretendimeve kundër Fondit HNS, të marrë vendime në lidhje me shpërndarjen ndërmjet pretenduesve të shumës së disponueshme të dëmshpërblimit në përputhje me nenin 14 dhe të përcaktojnë termat dhe kushtet sipas të cilave do të bëhen pagesat provizore në lidhje me pretendimet, me synimin që të sigurojë që viktimat e dëmeve të dëmshpërblehen sa më shpejt që të jetë e mundur;

i) të ngrejë një komitet për pretendimet për dëmshpërblime me të paktën 7 dhe jo më shumë se 15 anëtarë dhe çdo organ tjetër zëvendësues të përkohshëm apo të përhershëm që ajo mund ta çmojë të nevojshëm, të përcaktojnë termat e tij të referencës dhe t'i japë atij autoritetin e nevojshëm për të kryer funksionet që i caktohen; kur të emërojnë anëtarët e një organi të tillë, Asambleja do të bëjë përpjekje që të sigurojë një shpërndarje të barabartë gjeografike të anëtarëve dhe të sigurojë që shtetet palë të përfaqësohen në mënyrën e duhur; Rregullat e procedurës së Asamblesë mund të zbatohen *mutatis mutandis* për punën e këtij organi zëvendësues;

j) të përcaktojnë se cilat shtete jo palë në këtë Konventë, cilët anëtarë të asociuar të organizatës dhe cilat organizata ndërqeveritare dhe organizata ndërkombëtare joqeveritare do të pranohen të marrin pjesë, pa të drejtë vote, në takimet e Asamblesë dhe të organeve vartëse;

k) të japë udhëzime në lidhje me administrimin e Fondit HNS për drejtorin dhe organet vartëse;

l) të mbikëqyrin zbatimin e duhur të kësaj Konvente dhe të vendimeve të saj;

m) të rishikojnë çdo pesë vjet zbatimin e kësaj Konvente duke i kushtuar vëmendje të veçantë mbarëvajtjes së sistemit për llogaritjen e detyrimeve dhe mekanizmin e kontributit për tregtinë e jashtme; dhe

n) të kryejnë detyrat e tjera që i janë dhënë nga kjo Konventë ose që janë të nevojshme për operimin e duhur të Fondit HNS.

Neni 27

1. Sesionet e zakonshme të Asamblesë do të zhvillohen një herë në çdo vit kalendarik të thirrura nga drejtori.

2. Sesionet e jashtëzakonshme të Asamblesë do të thirren nga drejtori me kërkesën e të paktën një të tretës së anëtarëve të Asamblesë dhe mund të thirren me nismën e vetë drejtorit pas këshillimeve me Presidentin e Asamblesë. Drejtori do t'u japë njoftim anëtarëve të paktën tridhjetë ditë përpara këtyre sesioneve.

Neni 28

Shumica e anëtarëve të Asamblesë do të përbëjë kuorumin për mbledhjet e saj.

Sekretariati

Neni 29

1. Sekretariati mund të përfshijë drejtorin dhe personelin që mund të kërkohet për administrimin e Fondit HNS.

2. Drejtori do të jetë përfaqësuesi ligjor i Fondit HNS.

Neni 30

1. Drejtori do të jetë zyrtari administrativ kryesor i Fondit HNS. Sipas udhëzimeve të dhëna nga Asambleja, drejtori do të kryejë ato funksione që i caktohen drejtorit nga kjo Konventë, rregullat e brendshme të Fondit HNS dhe nga Asambleja.

2. Në veçanti, drejtori do të:

a) emërojë personelin e kërkuar për administrimin e Fondit HNS;

b) marrë të gjitha masat e duhura me synimin e administrimit të duhur të pasurive të Fondit HNS;

c) mbledhë kontributet që duhen sipas kësaj Konvente duke pasur veçanërisht parasysh dispozitat e nenit 22, paragrafi 2;

d) merret, për aq sa është e nevojshme, me pretendimet që ngrihen kundër Fondit HNS dhe për të kryer funksionet e tjera të Fondit HNS, të përdorë shërbimet e ekspertëve financiarë, ligjorë e të tjerë;

e) marrë të gjitha masat e duhura për të trajtuar pretendimet kundër Fondit HNS, brenda kufijve dhe në kushtet që do të përcaktohen në rregulloret e brendshme të Fondit HNS, përfshirë këtu zgjidhjen përfundimtare të pretendimeve pa miratimin paraprak të Asamblesë kur rregulloret e lejojnë këtë;

f) përgatisë dhe paraqesë pranë Asamblesë bilancet financiare dhe vlerat e buxhetit për çdo vit kalendarik;

g) në këshillim me Presidentin e Asamblesë, do të përgatisë dhe publikojë një raport mbi veprimtaritë e Fondit HNS gjatë vitit kalendarik paraardhës; dhe

h) përgatisë, mbledhë dhe qarkullojë dokumentet dhe informacionin që mund të kërkohet për punën e Asamblesë dhe organeve vartëse.

Neni 31

Në kryerjen e detyrave të tyre, drejtori, personeli dhe ekspertët e emëruar nga drejtori nuk do të kërkojnë apo marrin udhëzime nga asnjë qeveri apo nga asnjë autoritet jashtë Fondit HNS. Ata nuk do të përfshihen në asnjë veprim i cili mund të japë pasqyrim negativ në pozicionin e tyre si zyrtarë të brendshëm. Secili shtet palë nga ana e vet merr përsipër të respektojë natyrën ekskluzivisht ndërkombëtare të përgjegjësive të drejtorit dhe personelit e ekspertëve të emëruar nga drejtori dhe të mos përpiqet t'i ndikojë ata në kryerjen e detyrave të tyre.

Financat
Neni 32

1. Secili shtet palë do të përballojë pagesën, udhëtimin dhe shpenzimet e tjera të delegacionit të tij në Asamble, si dhe të përfaqësuesve të tij në organet zëvendësuese.

2. Çfarëdo shpenzimesh të tjera që janë shkaktuar në operimin e Fondit HNS do të përballohen nga Fondi HNS.

Votimi
Neni 33

Dispozitat në vijim do të zbatohen në lidhje me votimin në Asamble:

- a) secili anëtar do të ketë një votë;
- b) përveçse kur parashikohet ndryshe në nenin 34, vendimet e Asamblesë do të merren me shumicën e votave të atyre anëtarëve që janë të pranishëm e që votojnë;
- c) vendimet për të cilat kërkohet një shumicë prej dy të tretash do të merren me dy të tretat e votave të anëtarëve të pranishëm; dhe
- d) për qëllime të këtij neni, shprehja “anëtarë të pranishëm” nënkupton “anëtarë të pranishëm në takim në kohën e votimit” dhe shprehja “anëtarë të pranishëm dhe që votojnë” nënkupton “anëtarë të pranishëm dhe që shprehin një votë pro ose kundër”. Anëtarët që abstenojnë nga votimi do të quhet se nuk votojnë.

Neni 34

Vendimet e mëposhtme do të kërkohet të merren me një shumicë prej dy të tretash:

- a) një vendim sipas nenit 19, paragrafëve 4 ose 5 për të pezulluar apo rivendosur operimin e një llogarie të veçantë;
- b) një vendim sipas nenit 22, paragrafi 2, për të mos marrë apo për të mos vazhduar veprimet kundër një kontribuesi;
- c) emërimin e drejtorit sipas nenit 26 (d);
- d) krijimin e organeve zëvendësuese sipas nenit 26 (i) dhe çështjet që lidhen me këtë krijim;
- e) një vendim sipas nenit 51, paragrafi 1, që kjo Konventë do të vazhdojë të jetë në fuqi.

Rregullat mbi përjashtimet nga taksat dhe mbi monedhën

Neni 35

1. Fondi HNS, pronat, të ardhurat, përfshirë këtu edhe kontributet, si edhe pasuri të tjera të nevojshme për ushtrimin e funksioneve të tij siç përshkruhen në nenin 13, paragrafi 1, do të gëzojnë në të gjitha shtetet palë përjashtimin nga të gjitha format e taksimit të drejtpërdrejtë.

2. Kur Fondi HNS bën blerje të mëdha të pronave të luajtshme apo të paluajtshme apo të shërbimeve që janë të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive të tij zyrtare, me qëllim që të arrijë qëllimet e tij që përcaktohen në nenin 13, paragrafi 1, kostoja e të cilave përfshin taksa jo të drejtpërdrejta ose taksa mbi shitjet, qeveritë e shteteve palë, kurdoherë që është e mundur, do të marrin masat e duhura për rikthimin e fondeve ose rimbursimin e shumës së këtyre detyrimeve dhe taksave. Mallrat e përftuara në këtë mënyrë nuk do të shiten kundrejt pagesës apo të falën, përveçse kur kjo kryhet në përputhje me kushtet e miratuara nga qeveria e shtetit që ka dhënë apo mbështetur kthimin ose rimbursimin.

3. Asnjë përjashtim nuk do të bëhet në rastin e detyrimeve, taksave apo tatimeve që përbëjnë thjesht pagimin e shërbimeve publike utilitare.

4. Fondi HNS do të gëzojë përjashtim nga të gjitha detyrimet dhe taksat doganore, si edhe taksa të tjera të lidhura me to për artikujt e importuar apo të eksportuar nga vetë ai ose në emër të tij për përdorimin e tij zyrtar. Artikujt e importuar në këtë mënyrë nuk do të transferohen qoftë për shpërbllim qoftë gratis në territorin e vendit në të cilin ato janë importuar, përveçse në kushtet e rëna dakord nga qeveria e atij vendi.

5. Personat që kontribuojnë për Fondin HNS, si edhe viktimat dhe pronarët që marrin dëmshpërblim nga Fondi HNS do t'i nënshtrohen legjislacionit fiskal të shtetit ku ato janë të tatueshme, duke mos iu dhënë atyre në lidhje me këtë asnjë përjashtim i veçantë apo përfitim tjetër.

6. Pavarësisht nga rregullat ekzistuese apo ato të ardhshme në lidhje me monedhën apo transferimet, shtetet palë autorizojnë transferimin dhe pagesën e cilitdo kontribut për Fondin HNS dhe të çdo dëmshpërblimi të paguar nga Fondi HNS pa asnjë kufizim.

Konfidencialiteti i informacionit

Neni 36

Informacioni në lidhje me kontribuesit individualë i siguruar për qëllime të kësaj konvente nuk do të përhapet jashtë Fondit HNS, përveçse për aq sa mund të jetë ngushtësisht e nevojshme për ta mundësuar Fondin HNS që të kryejë funksionet e tij duke përfshirë këtu ngritjen e dhe mbrojtjen në procedime ligjore.

KREU IV

PRETENDIMET DHE VEPRIMET

Kufizimi i veprimeve

Neni 37

1. Të drejtat për dëmshpërblim sipas kreut II do të shuhen nëse një procedim ligjor nuk ka filluar brenda tre viteve nga data kur personi që ka vuajtur dëmin ka marrë dijëni apo në mënyrë të arsyeshme duhet të kishte marrë dijëni mbi dëmin dhe identitetin e pronarit.

2. Të drejtat për dëmshpërblim, sipas kreut III, do të shuhen nëse një procedim ligjor nuk ka filluar apo nëse nuk është bërë një njoftim në përputhje me nenin 39, paragrafi 7, brenda tre viteve nga data kur personi që ka vuajtur dëmin, ka marrë dijëni apo në mënyrë të arsyeshme duhet të kishte marrë dijëni mbi dëmin.

3. Megjithatë, në asnjë rast nuk mund të ngrihet një procedim ligjor më vonë se dhjetë vjet nga data e incidentit që shkaktoi dëmin.

4. Kur incidenti ka sjellë një vijimësi ndodhish të tjera, periudha prej dhjetë vjetësh e përmendur në paragrafin 3 do të fillojë nga data e më të fundit nga këto ndodhi.

Juridiksioni në lidhje me procedimet kundër pronarit

Neni 38

1. Kur incidenti ka shkakuar dëm në territorin, përfshirë këtu në detin territorial ose në një zonë që referohet në nenin 3 (b), të njërit apo më shumë shteteve palë, ose kur janë marrë masa për të parandaluar apo pakësuar dëmin në këtë territor, përfshirë këtu detin territorial ose këtë zonë, procedimet për dëmshpërblim mund të ngrihen kundër pronarit ose personave të tjerë që jep garanci financiare për përgjegjësinë e pronarit vetëm përpara gjykatave të cilitdo nga këto shtete palë.

2. Kur një incident ka shkakuar dëm ekskluzivisht jashtë territorit të cilitdo nga shtetet, përfshirë këtu detin territorial, dhe kur janë plotësuar kushtet e parashikuara në nenin 3 (c) për zbatimin e kësaj Konvente ose janë marrë masa parandaluese për të parandaluar apo pakësuar këtë dëm, procedimet për dëmshpërblime mund të ngrihen kundër pronarit apo personit tjetër që jep garanci financiare për përgjegjësinë e pronarit vetëm përpara gjykatave të:

a) Shtetit palë ku është regjistruar anija ose në rastin e një anijeje të paregjistruar, shtetit palë, flamurin e të cilit anija ka të drejtë të mbajë; ose

b) Shtetit palë ku pronari ka vendbanimin e përhershëm ose ku është vendosur qendra kryesore e punës së pronarit; ose

c) Shteti palë ku është ngritur një fond në përputhje me nenin 9, paragrafi 3.

3. Të paditurit do t'i jepet njoftim i arsyeshëm mbi çdo procedim të ndërmarrë sipas paragrafëve 1 ose 2.

4. Secili shtet palë do të sigurojë që gjykatat e tij të kenë juridiksion që të merren me procedimet për dëmshpërblime sipas kësaj Konvente.

5. Pasi është ngritur një fond sipas nenit 9 nga pronari ose nga siguruesi apo një person tjetër që jep garanci financiare në përputhje me nenin 12, gjykatat e shtetit në të cilin është ngritur ky fond do të kenë juridiksionin ekskluziv për t'i zgjidhur të gjitha çështjet në lidhje me pjesëtimin dhe shpërndarjen e fondit.

Juridiksioni në lidhje me procedimet kundër Fondit HNS ose të marra nga Fondi HNS

Neni 39

1. Në pajtim me dispozitat e mëposhtme të këtij neni, cilido procedim kundër Fondit HNS për dëmshpërblime sipas nenit 14 do të ngrihet vetëm përpara një gjykate që ka juridiksion sipas nenit 38 në lidhje me procedimet kundër pronarit që është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga incidenti përkatës ose para një gjykate në një shtet palë e cila do të kishte qenë kompetente nëse një pronar do të kishte qenë përgjegjës.

2. Në rastin kur anija që transporton lëndë të rrezikshme ose helmuese të cilat kanë shkaktuar dëmin nuk është identifikuar, dispozitat e nenit 38, paragrafi 1, do të zbatohen *mutatis mutandis* për procedimet kundër Fondit HNS.

3. Secili shtet palë do të sigurojë që gjykatat e tij të kenë juridiksion për t'u marrë me procedime të tilla kundër Fondit HNS siç referohen në paragrafin 1.

4. Kur një procedim për dëmshpërblim për dëme është ngritur para një gjykate kundër pronarit ose garantuesit të pronarit, kjo gjykatë do të ketë juridiksionin ekskluziv mbi çdo procedim kundër Fondit HNS për dëmshpërblime sipas dispozitave të nenit 14 në lidhje me këtë dëm.

5. Secili shtet palë do të sigurojë që Fondi HNS të ketë të drejtën të ndërhyjë si palë në cilindo procedim ligjor të ngritur në përputhje me këtë Konventë para një gjykate kompetente të atij shteti kundër pronarit ose garantuesit të pronarit.

6. Përveçse sa parashikohet ndryshe në paragrafin 7, Fondi HNS nuk do të jetë i detyruar nga asnjë gjykim apo vendim në procedime në të cilat ai nuk ka qenë palë ose nga asnjë zgjidhje me pajtim në të cilën ai nuk është palë.

7. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 5, kur një procedim sipas kësaj Konvente për dëmshpërblim për dëme është ngritur kundër një pronari ose garantuesit të pronarit para një gjykate kompetente në atë shtet palë, secila palë në procedime do të ketë të drejtë, sipas legjislacionit të brendshëm të atij Shteti, të njoftojë Fondin HNS mbi procedimet. Kur ky njoftim është bërë në përputhje me formalitetet e kërkuara nga ligji i gjykatës së përfshirë dhe në një kohë dhe mënyrë të tillë që Fondi HNS ka qenë faktikisht në pozitën që vërtet mund të ndërhynte si palë në procedime, çfarëdo vendimi përfundimtar i dhënë nga gjykata në këto procedime, pasi të jetë bërë i formës së prerë dhe i zbatueshëm në shtetin ku është dhënë ky vendim, do të bëhet detyrues për Fondin HNS në kuptimin që faktet dhe rezultatet në atë vendim nuk mund të diskutohen më nga Fondi HNS edhe nëse Fondi HNS nuk ka ndërhyrë në të vërtetë në proces.

Njohja dhe zbatimi

Neni 40

1. Çdo vendim i dhënë nga një gjykatë me juridiksion në përputhje me nenin 38, i cili është i zbatueshëm në shtetin e origjinës dhe kur nuk i nënshtrohet më formave të zakonshme të rishikimit gjyqësor, do të njihet nga cilido shtet palë, përveçse kur:

a) vendimi është marrë me mashtrim; ose

b) të paditurit nuk i është dhënë njoftim në kohë të arsyeshme dhe as një mundësi e drejtë për të paraqitur mbrojtjen e tij.

2. Një vendim i cili është njohur sipas paragrafit 1 do të jetë i zbatueshëm në secilin shtet palë sa më shpejt që të jenë plotësuar formalitetet e kërkuara në atë shtet. Formalitetet nuk do të lejojnë që të rihapet shqyrtimi i hollësive të çështjes.

3. Duke iu nënshtruar cilitdo vendim në lidhje me shpërndarjen e referuar në nenin 14, paragrafi 6, cilitdo vendim i dhënë kundër Fondit HNS nga një gjykatë që ka juridiksion në përputhje me nenin 39, paragrafët 1 dhe 3, kur është bërë i zbatueshëm në Shtetin e origjinës dhe kur nuk i nënshtrohet më formave të zakonshme të rishikimit gjyqësor, do të njihet dhe do të jetë i zbatueshëm në atë Shtet.

Zëvendësimi dhe rekursi

Neni 41

1. Fondi HNS, në lidhje me çfarëdo shume dëmshpërblimi për dëme të paguara nga Fondi HNS në përputhje me nenin 14, paragrafi 1, do të fitojë me zëvendësim të drejtat që personi i dëmshpërblyer në këtë mënyrë mund të gëzojë kundrejt pronarit ose garantuesit të pronarit.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk do të pengojë asnjë të drejtë rekursi ose zëvendësimi të Fondit HNS kundër cilitdo person, përfshirë personat e referuar në nenin 7, paragrafi 2 (d), të ndryshëm nga ata që referohen në paragrafin paraardhës, në masën që ato mund të kufizojnë përgjegjësinë e tyre. Në çdo rast, e drejta e Fondit HNS për zëvendësim kundër këtyre personave nuk do të jetë më pak e favorshme sesa ajo e një siguruesi të një personi të cilit i është paguar dëmshpërblimi.

3. Pa cenuar asnjë të drejtë zëvendësimi ose rekursi që mund të ekzistojë kundër Fondit HNS, një shtet palë ose agjenci e cila ka paguar dëmshpërblim për dëme në përputhje me dispozitat e legjislationit të brendshëm, do të fitojë me zëvendësim të drejtat që personi i dëmshpërblyer në këtë mënyrë do të kishte gëzuar sipas kësaj Konvente.

Klauzola e përparësisë

Neni 42

Kjo Konventë do të ketë përparësi ndaj çdo konvente në fuqi apo të hapur për nënshkrim, ratifikim ose aderim në datën në të cilën kjo Konventë është e hapur për nënshkrim, por vetëm në masën që kjo konventë është në kundërshtim me të; sidoqoftë, asgjë në këtë nen nuk do të prekë detyrimet e shteteve palë ndaj shteteve që nuk janë palë në këtë Konventë e që rrjedhin nga një konventë e tillë.

KREU V

DISPOZITA TË PËRKOHSHME

Informacioni mbi ngarkesat shkaktuese

Neni 43

Gjatë depozitimit të një instrumenti që referohet në nenin 45, paragrafi 3, si dhe në çdo vit në vijim deri sa kjo konventë të hyjë në fuqi për atë shtet, ai shtet do t'i paraqesë Sekretarit të Përgjithshëm të dhëna mbi sasinë përkatëse të ngarkesave shkaktuese të marra ose, në rastin e LNG, të shkarkuara në atë shtet gjatë vitit kalendarik paraardhës në lidhje me llogarinë e përgjithshme dhe me llogaritë e veçanta.

Sesioni i parë i Asamblesë

Neni 44

Sekretari i Përgjithshëm do të thërresë sesionin e parë të Asamblesë. Ky sesion do të zhvillohet sa më shpejt që të jetë e mundur pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente dhe në çdo rast, jo më shumë se tridhjetë ditë pas kësaj hyrje në fuqi.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

Neni 45

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në qendrën e organizatës nga data 1 tetor 1996 deri më 30 shtator 1997 dhe do të mbetet e hapur për aderim edhe në vazhdim.
2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre që t'i nënshtrohen kësaj Konvente me anë të:
 - a) nënshkrimit pa rezerva për sa i përket ratifikimit, pranimit apo miratimit;
 - b) nënshkrimit në varësi të ratifikimit, pranimit apo miratimit, që ndiqet nga ratifikimi, pranimi apo miratimi; ose
 - c) aderimit.
- 3) Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të hyjnë në fuqi me anë të depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Hyrja në fuqi

Neni 46

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi tetëmbëdhjetë muaj pas datës në të cilën plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) të paktën dymbëdhjetë shtete, përfshirë këtu katër shtete secila me jo më pak se 2 milionë ton njësi tonazhi bruto, të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshtuar asaj; dhe
 - b) Sekretari i Përgjithshëm ka marrë informacion në përputhje me nenin 43 se ata persona në këto shtete të cilat do të ishin përgjegjës për të kontribuar në përputhje me nenin 18, paragrafët 1 (a) dhe (c), kanë marrë gjatë vitit kalendarik paraardhës një sasi të përgjithshme prej të paktën 40 milionë tonë ngarkesë që kontribuon në llogarinë e përgjithshme.
2. Për cilindo shtet i cili shpreh pëlqimin e tij për t'iu nënshtuar kësaj Konvente pasi të jenë plotësuar kushtet për hyrjen në fuqi, ky pëlqim do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së shprehjes së një pëlqimi të tillë ose në datën në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi në përputhje me paragrafin 1, cilado datë të jetë më e vonshme.

Rishikimi dhe ndryshimi

Neni 47

1. Një konferencë për qëllimin e rishikimit apo ndryshimit të kësaj Konvente mund të thirret nga Organizata.
2. Sekretari i Përgjithshëm do të thërrasë një konferencë të shteteve palë në këtë Konventë për të rishikuar ose ndryshuar Konventën me kërkesën e gjashtë shteteve palë ose një të tretës së shteteve palë, cilado shifër të jetë më e lartë.
3. Çdo pëlqim për t'iu nënshtuar kësaj Konvente, i shprehur pas datës së hyrjes në fuqi të një ndryshimi ndaj kësaj Konvente, do të quhet se zbatohet për Konventën, e ndryshuar.

Ndryshimi i kufizimeve

Neni 48

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 47, procedura e posaçme e parashikuar në këtë nen do të zbatohet vetëm për qëllimet e ndryshimit të kufizimeve të përcaktuara në nenin 9, paragrafi 1 dhe nenin 14, paragrafi 5.
2. Me kërkesën e të paktën gjysmës, por në asnjë rast jo më pak se gjashtë shteteve palë, çdo propozim për të ndryshuar kufizimet e përcaktuara në nenin 9, paragrafi 1, si dhe në nenin 14, paragrafi 5, do të qarkullohet nga Sekretari i Përgjithshëm për të gjithë Anëtarët e Organizatës dhe për të gjitha shtetet kontraktuese.

3. Çdo ndryshim i propozuar dhe i qarkulluar si më sipër do t'i paraqitet Komisionit Ligjor të Organizatës (Komisionit Ligjor) për shqyrtim në një datë të paktën gjashtë muaj pas datës së qarkullimit të tij.

4. Të gjitha shtetet kontraktuese, qoftë anëtarë të organizatës apo jo, do të kenë të drejtë të marrin pjesë në procedimet e Komisionit Ligjor për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimeve.

5. Ndryshimet do të miratohen me një shumicë prej dy të tretat e shteteve kontraktuese të pranishme dhe që votojnë në Komisionin Ligjor, zgjeruar sipas parashikimeve të paragrafit 4, me kushtin që të paktën gjysma e shteteve kontraktuese të jenë të pranishme në kohën e votimit.

6. Kur vepron mbi një propozim për të ndryshuar kufizimet, Komisioni Ligjor do të ketë parasysh përvojën e incidenteve të ndodhura, veçanërisht shumën e dëmit që ka ardhur si pasojë e tyre, ndryshimet në vlerat monetare dhe pasojat e ndryshimit të propozuar mbi kostot e sigurimeve. Ai do të marrë gjithashtu parasysh marrëdhënien ndërmjet kufijve të vendosur në nenin 9, paragrafi 1 dhe atyre në nenin 14, paragrafi 5.

7. a) Asnjë ndryshim i kufizimeve sipas këtij neni nuk mund të shqyrtohet përpara se të kenë kaluar pesë vjet nga data në të cilën kjo Konventë është hapur për nënshkrim e as para se të kenë kaluar pesë vjet që nga data e hyrjes në fuqi të një ndryshimi të mëparshëm sipas këtij neni.

b) Asnjë kufizim nuk mund të rritet aq sa të kalojë shumën që i korrespondon një kufizimi të përcaktuar në këtë Konventë të shtuar me gjashtë për qind në vit, të llogaritur mbi bazë të përzier nga data në të cilën kjo Konventë është hapur për nënshkrim.

c) Asnjë kufizim nuk mund të rritet aq sa të kalojë shumën që i korrespondon një kufizimi të vendosur në këtë Konventë i shumëzuar për tre.

8. Çdo ndryshim i miratuar në përputhje me paragrafin 5 do t'u njoftohet të gjitha shteteve kontraktuese nga Organizata. Ndryshimi do të quhet se është pranuar në fund të një periudhe prej tetëmbëdhjetë muajsh pas datës së njoftimit, përveçse kur brenda asaj periudhe, jo më pak se një e katërta e shteteve që ishin shtete kontraktuese në kohën e miratimit të ndryshimit i kanë komunikuar Sekretarit të Përgjigjëm se ato nuk e pranojnë ndryshimin, rast në të cilin ndryshimi hidhet poshtë dhe nuk sjell pasoja.

9. Një ndryshim që quhet se është pranuar në përputhje me paragrafin 8 do të hyjë në fuqi tetëmbëdhjetë muaj pas pranimit të tij.

10. Të gjitha shtetet kontraktuese do t'i nënshtrohen këtij ndryshimi, përveçse kur ato e denoncojnë këtë Konventë në përputhje me nenin 49, paragrafët 1 dhe 2, të paktën gjashtë muaj para se ndryshimi të hyjë në fuqi. Ky denoncim do të hyjë në fuqi kur ndryshimi të hyjë në fuqi.

11. Kur është miratuar një ndryshim por nuk ka kaluar ende periudha prej tetëmbëdhjetë muajsh për pranimin e tij, një shtet që bëhet shtet kontraktues gjatë asaj periudhe do t'i nënshtrohet ndryshimit nëse ky hyn në fuqi. Një shtet i cili bëhet shtet kontraktues pas asaj periudhe do t'i nënshtrohet një ndryshimi i cili është pranuar në përputhje me paragrafin 8, në rastet e referuara në këtë paragraf, një shtet i nënshtrohet një ndryshimi kur ai ndryshim hyn në fuqi ose Konventë hyn në fuqi për atë shtet, nëse data e kësaj të fundit është më e vonshme.

Denoncimi

Neni 49

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga secili shtet në çdo kohë pas datës në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për atë shtet.

2. Denoncimi do të kryhet me anë të depozitimit të një instrumenti denoncimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Një denoncim do të hyjë në fuqi dymbëdhjetë muaj pas depozitimit të tij pranë Sekretarit të Përgjithshëm ose një periudhe të tillë më të gjatë që mund të përcaktohet në instrumentin e denoncimit, pas depozitimit të tij pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

4. Pavarësisht nga një denoncim i bërë nga një shtet palë në pajtim me këtë nen, cilatdo dispozita të kësaj Konvente në lidhje me detyrimet për të dhënë kontribute sipas neneve 18, 19 ose nenit 21, paragrafi 5, në lidhje me pagesa të tilla dëmshpërblimesh që mund të vendosë Asambleja në lidhje me një incident i cili ndodh përpara hyrjes në fuqi të denoncimit, do të vazhdojnë të zbatohen.

Sesionet e jashtëzakonshme të Asamblesë

Neni 50

1. Cilido shtet palë, brenda nëntëdhjetë ditëve pas depozitimit të një instrumenti denoncimi si rrjedhojë e të cilit ai çmon se do të ketë një rritje të rëndësishme në nivelin e kontributeve nga shtetet palë që mbeten, mund t'i kërkojë drejtorit që të thërrasë një sesion të jashtëzakonshëm të Asamblesë. Drejtori do të thërrasë Asambleshën për t'u mbledhur brenda jo më pak se gjashtëdhjetë ditëve pas marrjes së kërkesës.

2. Drejtori mund të ndërmarrë nismën që të thërrasë një sesion të jashtëzakonshëm të Asamblesë që të mbledhet brenda gjashtëdhjetë ditëve pas depozitimit të një instrumenti denoncimi, nëse drejtori çmon se ky denoncim do të sjellë si pasojë një rritje të ndjeshme në nivelin e kontributeve nga shtetet palë që mbeten.

3. Nëse Asambleja në një sesion të jashtëzakonshëm, të mbledhur në përputhje me paragrafët 1 ose 2, vendos se denoncimi do të sjellë një rritje të ndjeshme në nivelin e kontributeve nga shtetet palë që mbeten, cilido shtet nga këta, jo më vonë se njëqind e njëzet ditë përpara datës në të cilën denoncimi të hyjë në fuqi, mund ta denoncojë këtë Konventë me efekt që nga e njëjta datë.

Pushimi

Neni 51

1. Kjo Konventë do të pushojë së qeni në fuqi:

a) në datën kur numri i shteteve palë bie nën 6; ose

b) dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën të dhënat në lidhje me një vit të mëparshëm kalendarik duhet t'i komunikoheshin drejtorit në përputhje me nenin 21, nëse të dhënat tregojnë se sasia e përgjithshme e ngarkesës shkaktuese në llogarinë e përgjithshme në përputhje me nenin 18, paragrafët 1 (a) dhe (c) të marra në shtetet palë në atë vit të mëparshëm kalendarik ishin më pak se 30 milionë ton.

Pavarësisht pikës (b), nëse sasia e përgjithshme e ngarkesës shkaktuese në llogarinë e përgjithshme në përputhje me nenin 18, paragrafët 1 (a) dhe (c) të marrë nga shtetet palë në vitin e mëparshëm kalendarik ishte më pak se 30 milionë tonë, por më shumë se 25 milionë ton, Asambleja, kur quan se kjo ka ndodhur për rrethana të jashtëzakonshme dhe nuk ka të ngjarë të përsëritet, mund të vendosë përpara kalimit të periudhës së sipërpërmendur dymbëdhjetë mujore se Konventa do të vazhdojë të mbetet në fuqi. Sidoqoftë, Asambleja nuk mund të marrë një vendim të tillë për më shumë se dy vite të njëpasnjëshme.

2. Shtetet të cilat i nënshtrohen kësaj Konvente në ditën përpara datës në të cilën ajo pushon së qeni në fuqi, do t'i mundësojnë Fondit HNS të ushtrojë funksionet e tij siç përshkruhen në nenin 52 dhe vetëm për këtë qëllim, do të vazhdojnë t'i nënshtrohen kësaj Konvente.

Likuidimi i Fondit HNS

Neni 52

1. Nëse kjo Konventë pushon së qeni në fuqi, Fondi HNS sidoqoftë do të:

a) përmbushë detyrimet e tij në lidhje me çdo incident të ndodhur përpara se kjo Konventë të pushojë që qeni në fuqi; dhe

b) ketë të drejtën të ushtrojë të drejtat e tij mbi kontributet në masën që këto kontribute janë të nevojshme për të plotësuar detyrimet sipas pikës (a), duke përfshirë këtu shpenzimet për administrimin e Fondit HNS të nevojshme për këtë qëllim.

2. Asambleja do të marrë të gjitha masat e duhura për të plotësuar likuidimin e Fondit HNS duke përfshirë këtu edhe shpërndarjen në një mënyrë të drejtë të çdo pasurie të mbetur ndërmjet atyre personave që kanë kontribuar në Fondin HNS.

3. Për qëllime të këtij neni, Fondi HNS do të mbetet person juridik.

Depozitimi

Neni 53

1. Kjo Konventë dhe çdo ndryshim i miratuar sipas nenit 48 do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të:

a) Informojë të gjitha shtetet të cilat kanë nënshkruar ose kanë aderuar në këtë Konventë si dhe të gjithë anëtarët e organizatës për:

i) çdo nënshkrim të ri apo depozitim të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit së bashku me datën përkatëse;

ii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente;

iii) çfarëdo propozimi për të ndryshuar kufizimet mbi shumat e dëmshpërblimeve që është bërë në përputhje me nenin 48, paragrafi 2;

iv) çdo ndryshim që është miratuar në përputhje me nenin 48, paragrafi 5;

v) çdo ndryshim që quhet se është pranuar sipas nenit 48, paragrafi 8, së bashku me datën në të cilën ai ndryshim do të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafët 9 dhe 10 të atij neni;

vi) depozitimin e cilitdo instrument denoncimi të kësaj Konvente, së bashku me datën e depozitimit dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi; dhe

vii) çdo komunikim të përshtatshëm në lidhje me çdo nen të kësaj Konvente; dhe

b) Përcjellë kopje të vërtetuara të kësaj Konvente ndaj të gjitha shteteve të cilat, kanë nënshkruar këtë Konventë dhe ndaj shteteve të cilat aderojnë në këtë Konventë.

Gjuhët

Neni 54

Kjo Konventë përgatitet në një original të vetëm në gjuhën arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, duke qenë secili tekst njëlloj autentik.

(vendosni dispozita)

(vendosni klauzola (nëse ka: nënshkruar; dëshmuar: bërë; tekste origjinale; & klauzola të depozituara)

Bërë në Londër më tre maj, njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë.

Në dëshmi sa më sipër, nënshkruerit, duke qenë të autorizuar në mënyrën e duhur nga qeveritë e tyre përkatëse, nënshkruan për këtë qëllim këtë Konventë.

SHTOJCA

SHTOJCA I

CERTIFIKATË E SIGURIMIT APO SIGURISË TJETËR FINANCIARE NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA LËNDËT E RREZIKSHME DHE HELMUESE (HNS)

Lëshuar në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Konventës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë dhe Dëmshpërblimin për Dëmet e Shkaktuara nga Transportimi i Lëndëve të Rrezikshme dhe Helmuese, të vitit 1996

Emri i anijes	Numrat apo shkronjat dalluese	Numri i identifikimit të anijes i Organizatës Ndërkombëtare Detare IMO	Porti i regjistrimit	Emri dhe adresa e plotë e vendit kryesor të punës së pronarit të regjistruar

Me anë të kësaj certifikate vërtetohet se në lidhje me anijen e sipërpërmendur është në fuqi një policë sigurimi ose një siguri tjetër financiare që përmbush kërkesat e nenit 12 të Konventës Ndërkombëtare mbi Përgjegjësinë dhe Dëmshpërblimin për Dëmet e Shkaktuara nga Transportimi i Lëndëve të Rrezikshme dhe Helmuese, të vitit 1996.

2. Detyrimi për pikë HNS do të jetë shuma e përgjithshme e kontributeve për t'u vendosur si detyrim e në llogarinë e përgjithshme e pjesëtuar me totalin e pikëve HNS për të gjithë sektorët.

3. Totali i pikëve HNS për secilin sektor do të jetë i barabartë me produktin e vëllimit të përgjithshëm të ngarkesës shkaktuese për atë sektor, të matur në ton metrik, dhe faktori korrespondues i sektorit.

4. Një faktor i sektorit do të llogaritet si mesatarja e ponderuar aritmetike e raportit pretendimeve/vëllim për atë sektor për vitin përkatës dhe për nëntë vitet paraardhëse, në përputhje me këtë rregullore.

5. Përveçse për sa parashikohet në paragrafin 6, raporti pretendime / vëllim për secilin nga këto vite do të përlllogaritet si vijon:

a) pretendimet e përcaktuara, të matura në njësi të llogarisë, të kthyera nga monedha në të cilën ngrihet pretendimi duke përdorur kursin e zbatueshëm në datën e incidentit në fjalë, për dëme të shkaktuara nga lëndët në lidhje me të cilat duhen dhënë kontributet për Fondin HNS për vitin përkatës; të pjesëtuar me

b) vëllimin e ngarkesës shkaktuese që i korrespondon vitit përkatës.

6. Në rastet kur informacioni i kërkuar në paragrafët 5 (a) dhe (b) nuk është i disponueshëm, vlerat në vijim do të përdoren për raportin pretendime / vëllim për secilin nga vitet që mungojnë:

a) materialet e ngurta në sasi të mëdha të referuara në nenin 1, paragrafi 5 (a) (vii) 0;

b) karburantet, nëse operimi i llogarisë së karburanteve është shtyrë 0;

c) LNG, nëse operimi i llogarisë LNG është shtyrë 0;

d) LPG, nëse operimi i llogarisë LPG është shtyrë 0;

e) lëndë të tjera 0.0001.

7. Mesatarja aritmetike e dhjetë viteve do të rregullohet në një shkallë lineare zbritëse me qëllim që raporti i vitit përkatës të ketë një vlerë prej 10, viti i mëparshëm të ketë një vlerë prej 9, viti tjetër paraardhës të ketë një vlerë prej 8 e kështu me radhë deri sa viti i dhjetë të ketë një vlerë prej 1.

8. Nëse operimi i një llogarie të veçantë është pezulluar, faktori përkatës i sektorit do të përlllogaritet në përputhje me ato dispozita të kësaj rregulloreje që Asambleja do t'i vlerësojë si të përshtatshme.

RREGULLORE

Nr.10, datë 18.6.2010

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR PAJISJEN ME LEJE DHE TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË PESHKIMIT NË DET, NË UJËRAT E BRENDSHME DHE AKUAKULTURËN TOKËSORE DHE UJORE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të germave “ë” dhe “i” të nenit 32 të ligjit nr.7908, datë 5.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, i ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.547, datë 13.05.2009 “Për procedurat dhe çmimet për dhënien me qira të sipërfaqeve ujore për qëllime të akuakulturës intensive”, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave miraton rregulloren si më poshtë:

KREU I

QËLLIMI DHE PËRKUFIZIME

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për:

a) kërkimin e lejeve të peshkimit, shqyrtimin e kërkesës e të dokumentacionit që e shoqëron dhe lëshimin e aktit të miratimit të saj;

b) zhvillimin e konkurrimit publik në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore.

Neni 2 Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje:

1. Anije peshkimi është çfarëdo lloj anije e pajisur për peshkimin industrial të burimeve ujore të gjalla, duke përfshirë anijet mbështetëse dhe çdo anije tjetër të përfshirë në veprimtarinë e peshkimit.

2. Motoskaf është një mjet lundrues me një raport fuqi/peshe shumë të lartë. Motoskafët mund të jenë me motor fuoribord ose me motor të brendshëm.

3. Autoriteti i menaxhimit të peshkimit është Ministria, e caktuar me ligj për të kryer funksionet e menaxhimit të peshkimit.

4. Kontrolli është një inspektim i planifikuar ose jo, i ushtruar nga sektori për kontrollin e peshkimit, i cili ka për qëllim:

a) verifikimin e përputhshmërisë së veprimtarisë që kontrollohet me kërkesat e legjislacionit të peshkimit;

b) monitorimin e aktiviteteve të licencuara, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në licencën e miratuar.

5. Leje peshkimi është dokumenti që miratohet nga QKL për të kryer një aktivitet konkret peshkimi me një anije të caktuar, në kushte të përcaktuara, ku certifikohen minimalisht të dhënat lidhur me identifikimin e karakteristikave teknike dhe të ndërtimit të anijes sipas aktit të Miratimit të dhënë nga Ministria.

6. Kontratë për aktivitetin e peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturë është dokumenti që miratohet nga Ministria, ku përcaktohen kushtet dhe rrethanat detyrimisht të zbatueshme, në afatin e përcaktuar shprehimisht në të.

7. Ligj kuptohet ligji nr. 7908, datë 5.04.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën", i ndryshuar.

8. Monitorimi është procesi që përmbledh tërësinë e vëzhgimeve e vrojtimit mbi zhvillimin e aktivitetit të peshkimit. Monitorimi është kërkesë e vazhdueshme për marrjen e të dhënave të zënive, të përbërjes llojore, të sforcos së peshkimit, të flakjeve në det, të zonave dhe sezoneve të peshkimit. Monitorimi përfshin gjithashtu regjistrimin dhe mbajtjen e këtyre të dhënave që janë objekt i analizave dhe prognozave.

9. Organizatë kuptohet Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, e krijuar sipas nenit 26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 31/1 të ligjit.

10. Pajisje peshkimi kuptohen gjithë ato pajisje të destinuara për zënien e organizmave ujore.

11. Peshkim artizanal kupton format e peshkimit profesional me mjete fikse ose të lëvizshme si grepat (parangallet), mrezhat, njicat stavnik, bilanxh etj., që ushtrohen në ujëra bregdetare dhe ujëra të brendshme.

12. Peshkim fundor (demersal) kuptohet peshkimi i organizmave ujore që jetojnë në tabanin e ujërave. Ky peshkim realizohet me rrjeta që tërhiqen me një shpejtësi të caktuar mbi tabanin e ujërave me anë të fuqisë motorike.

13. Peshkim industrial kuptohen format e peshkimit profesional fundor, pelagjik dhe me rrethime.

14. Peshkim me mjete fikse ose stacionare kuptohet peshkimi me çdo lloj pajisje (rrjetë, kallam ose tub plastik a metalik i thurur etj.) e fiksuar e vendosur për zënien e organizmave ujore si p.sh. dajlane, prita, bilanxhe, stavnike etj.

15. Peshkim pelagjik kuptohet peshkimi i llojeve të peshqve që jetojnë në shtresën ujore ndërmjet fundit dhe sipërfaqes, qofshin këta të vegjël apo të mëdhenj (sardele, acuga, toni etj.).

16. Peshkim profesional kuptohet aktiviteti i peshkimit që kryhet për qëllime ekonomike dhe fitimi.

17. Peshkim me rrethim kuptohet peshkimi i llojeve të ndryshme të peshqve me rrjeta që mundësojnë rrethimin e tufave, (sardele, acuge) të grumbulluara për shkaqe biologjike ose jo.

18. Peshkim sportiv kuptohet aktiviteti i peshkimit që kryhet për qëllime dëfrimi, shlodhëse ose sportive dhe pa qëllim fitimi.

19. Port peshkimi kuptohet një port, liman i veçantë peshkimi ose zonë e caktuar brenda një porti tregtar, në të cilin ofrohen shërbimet për anijet e peshkimit së bashku me akuatoriumin, bankinat, territorin tokësor, ndërtesat dhe strukturat përkatëse.

20. Qendër peshkimi kuptohet një mol, urë në det ose valëpritës, në lagunë ose liqen që përdoret për qëllime peshkimi së bashku me territorin tokësor, ndërtesat dhe strukturat përkatëse.

21. Speciet objekt peshkimi (target) kuptohen speciet kryesore që duhet të zihen nga një anije ose një mjet në një formë peshkimi të caktuar. Në peshkimin pelagjik me koshilok kjo mund të jetë vetëm një specie (p.sh. sardele), ndërsa në peshkimin me koca mund të jetë një grup speciesh (p.sh. merluci, barbuni, gjuhëza etj).

22. Tonazh kuptohet tonazhi bruto i përcaktuar nga aneksi I i Konventës Ndërkombëtare mbi tonazhin e anijeve 1969. Tonazhi bruto përcaktohet me anë të formulës $GT=K1V$ ku V është volumi total i hapësirave të mbyllura të anijes në metër kub dhe $K1=02+0.02\log10V$.

23. Ujëra të brendshme përfshihen lagunat bregdetare, liqenet natyrore, liqenet e hidrocentraleve, ujëmbledhësit e bujqësisë, lumenjtë dhe ujëra të tjera të Republikës së Shqipërisë të ndryshme nga ujërat detare .

24. Ujëra territoriale janë ujërat e zonës detare në të cilat shteti bregdetar ushtron sovranitet të plotë. Zona e ujërave territoriale shtrihet deri në 12 milje detare largësi nga vija e zbatimit të bregut të detit. Ky përkufizim është përcaktuar nga Konferenca e Kombeve të Bashkuara për ligjin mbi detin (UNCLOS), i cili parashikon edhe rregulloret dhe menaxhimin e gjithë burimeve të gjalla, si edhe përcaktimin e Zonës Ekonomike Ekskluzive (EEZ).

25. Motofluge (ose motolance) është çfarëdolloj mjeti lundrues i përfshirë në veprimtarinë e peshkimit, me gjatësi deri në 15 m që plotëson kërkesat e neneve 38, 39, 40 të Kodit Detar të Republikës së Shqipërisë dhe që ka si vend të dislokimit të mjetit njërin nga katër portet e peshkimit: Sarandë, Vlorë, Durrës apo Shëngjin.

26. Sanall, lundër, sul, take dhe sinonime të ngjashme kuptohen çfarëdolloj mjeti lundrues i përfshirë në veprimtarinë e peshkimit, me gjatësi më të vogël se 15 m, jashtë kërkesave të pikës 25 të këtij neni dhe që nuk ka domosdoshmëri si vend të dislokimit të mjetit njërin nga katër portet e peshkimit: Sarandë, Vlorë, Durrës apo Shëngjin.

KREU II

KËRKESA DHE DOKUMENTACIONI PËR APLIKIM

Neni 3

Llojet e lejeve dhe e drejta për ushtrim aktiviteti në peshkim dhe akuakulturë

1. Në peshkimin detar me mjete lundruese me dhe pa kuvertë, motobarka ose anije peshkimi, për peshkim fundor, peshkim i pellagjikëve të vegjël dhe/ose të mëdhenj, peshkim molusqesh, me turbosofiante, selektive dhe peshkim bregdetar jepet leje peshkimi, e cila akordohet për çdo mjet lundrues të veçantë.

2. Për ujërat e brendshme e drejta e peshkimit fitohet nëpërmjet konkurrimit publik dhe me subjektet fituese Ministria lidh kontratë të zhvillimit të aktivitetit të peshkimit.

3. Në ato kategori ujore, të shpallura si zona bashkëmenaxhimi, ku ekzistojnë organizatat e menaxhimit të peshkimit (OMP), kontrata lidhet me OMP-në, e cila pajis anëtarët e vet peshkatarë me dokumentacionin përkatës të anëtarësisë. Në kontratë përcaktohen numri i anëtarëve, afati i kontratës, detyrimet e palëve dhe sanksionet në rast mosplotësimi të tyre.

4. Personat fizikë ose juridikë të interesuar për zhvillimin e akuakulturës, tokësore dhe ujore, në pronat publike, u nënshtrohen procedurave të konkurrimit publik. Me fituesin, Ministria ose përfaqësuesi i pronës shtetërore lidh kontratë qiraje. Procedurat për lidhjen e kontratës dhe ato të konkurrimit publik nuk zbatohen në rastet kur toka është në pronësi private.

Neni 4

Aplikimi dhe kërkesat për leje peshkimi në det

1. Aplikimi bëhet pranë QKL për format e peshkimit që janë të parashikuara për t'u pajisur me leje.

2. Lejet e peshkimit lëshohen nga QKL pas shqyrtimit dhe verifikimit për plotësimin e kriterëve të lejimit nga Drejtoria e Burimeve të Ujërave dhe Peshkimit (Drejtoria e Përgjithshme e Politikave) në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Vendimi i drejtorisë bazohet në vlerësimin e dokumenteve të paraqitura për përmbushjen e kriterëve të lejimit:

I. Për mjetin lundruar me kuvertë

a) Dëshmi pronësie (nga Kapiteneria e porteve).

b) Dëshmi Flamuri (nga Kapiteneria e porteve).

c) Certifikatë lundrimi (nga Regjistri Detar).

d) Certifikatë regjistrimi në QKR.

II. Për mjetin lundruar pa kuvertë (për peshkim artizanal)

a) Libri i mjetit lundruar (nga Kapiteneria e porteve).

b) Dokumenti i regjistrimit të mjetit lundruar (nga Policia Kufitare) ose vërtetim aplikimi pranë saj.

c) Certifikatë regjistrimi në QKR.

Neni 5

Aplikimi dhe kërkesat për konkurrimin publik për aktivitetin në ujërat e brendshme dhe akuakulturë

1. Për konkurrimin publik për ujërat e brendshme dhe akuakulturë, ministri ngre Komisionin e Vlerësimit të Kërkesave, i cili ka detyra të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

2. Njoftimi për botim për konkurrim të një kategorie të veçantë për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturës shpallet 2 herë në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për objektin ujqor, pikët vlerësuese për elementet e konkurrimit, dokumentacionin që duhet të paraqesin konkurrentët, si dhe vendin, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrimit të jetë jo më parë se 7 ditë kalendarike nga data e botimit të fundit.

3. Dokumentacioni i përgjithshëm që paraqesin pjesëmarrësit në konkurrim është:

a) kërkesa për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në objektin ujqor të shpallur për konkurrim;

b) regjistrimi në QKR;

c) planbiznesi për zhvillimin e veprimtarisë;

d) projekti teknik dhe dokumentacioni i nevojshëm teknik e ligjor;

e) niveli i investimit;

f) niveli i punësimit;

g) vetëdeklarim se projekti përputhet me kërkesat mjedisore të zonës në fjalë;

h) pagesa e tarifës së shërbimit.

4. Dokumentacioni i veçantë që paraqesin pjesëmarrësit në konkurrim për çdo kategori ujqore është:

a) për akuakulturën:

i) garancia financiare e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;

ii) prania e specialistit të fushës nëpërmjet CV profesionale, ku të tregohet përvoja në fushën e peshkimit dhe akuakulturës;

iii) vetëdeklarimi se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, nuk ka detyrime tatimore ose detyrime të tjera.

b) për ujëmbledhësit e bujqësisë:

i) të dhëna teknike për ujëmbledhësin dhe planvendosja e tij;

ii) marrëveshje ose kontratë përdorimi uji ose ujëmbledhësi me përfaqësuesin e organit që administron ujëmbledhësin;

iii) garancia financiare e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;

iv) vetëdeklarim se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, nuk ka detyrime tatimore ose detyrime të tjera.

c) për lagunat bregdetare, jo me dajlan:

i) plan vendosja e instalimeve peshkore;

ii) lloji i mjeteve të peshkimit;

iii) sasia (gjatësi dhe/ose numër);

iv) vetëdeklarimi se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, nuk ka detyrime tatimore ose detyrime të tjera.

d) për lumenjtë:

i) plan vendosja e instalimit të mjetit/mjeteve të peshkimit;

ii) lloji i mjeteve të peshkimit;

iii) sasia (gjatësi dhe/ose numër);

iv) vetëdeklarimi se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, nuk ka detyrime tatimore ose detyrime të tjera;

e) të tjera si: grumbullim/kultivim molusqesh bivalvore:

i) kategorizim nga autoriteti veterinar i zonës;

ii) lista dhe vendosja e të gjitha derdhjeve nga toka në det në raport me zonën ku synohet të zhvillohet aktiviteti;

iii) llojet që synohen të kultivohen ose grumbullohen;

iv) vetëdeklarimi se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, nuk ka detyrime tatimore ose detyrime të tjera;

v) garancia financiare e mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes.

Neni 6

Kriteret e konkurrimit

Kriteret e konkurrimit për të gjitha kategoritë ujore sipas planbiznesit janë:

a) Niveli i investimit;

b) Teknologjia e projektit;

c) Niveli i punësimit.

Neni 7

Kriteret e vlerësimit

a) Niveli i investimit 40 pikë

b) Teknologjia e projektit 40 pikë

c) Niveli i punësimit 20 pikë

d) Në rast klasifikimi me pikë të barabarta, CV e subjektit dhe eksperiencia në aktivitet ka përparësi.

Neni 8

Detyrat e Komisionit të Vlerësimit të Kërkesave

1. Komisioni i Vlerësimit ka këto detyra:

a) përgatit dokumentacionin për publikim dhe e shpall atë;

b) hap në prani të konkurrentëve dokumentacionin e paraqitur prej tyre, duke bërë të njohur të dhënat kryesore për çdo ofertë të paraqitur. Kur dokumentacioni i paraqitur nuk është i plotë, konkurrenti skualifikohet;

c) në rast se paraqitet një kërkesë e vetme, Komisioni i Vlerësimit rishpall edhe njëherë objektin në konkurrim; data e konkurrimit të dytë të jetë jo me parë se 7 ditë kalendarike nga data e shpalljes;

ç) në rast se edhe në datën e dytë të konkurrimit paraqitet një kërkesë e vetme, atëherë Komisioni bën vlerësimin edhe me një kërkesë të vetme;

d) harton procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, ku përshkruhen pjesëmarrësit, konkurrentët e skualifikuar dhe shkaku, konkurrentët e kualifikuar dhe lista e dokumenteve të paraqitura prej tyre;

e) bën shqyrtimin brenda 10 ditëve të dokumentacionit të paraqitur dhe vlerëson me pikë sipas pikës 1 të këtij neni çdo element konkurrimi, sipas përcaktimeve në njoftim;

f) verifikon nëse subjekti kërkuar është dënuar ose jo, në procedurë për shkelje ligjore në peshkim dhe/ose është debitor;

g) rendit, pas përfundimit të konkursit, konkurruesit në bazë të pikëve të fituara;

h) paraqet tek ministri, brenda afatit të përcaktuar në germën “e” të kësaj pike, një informacion për zhvillimin e konkursit, së bashku me procesverbalin dhe listën e konkurruesve, të renditur sipas pikëve të fituara për të kërkuar miratimin e procedurës;

i) Komisioni i Vlerësimit shpall subjektin fitues. Njoftimi për shpalljen fitues vendoset në këndin e njoftimeve të ministrisë.

Neni 9

Ankimi

Subjektet konkurruese, brenda 5 ditëve nga shpallja e subjektit fitues, kanë të drejtën e ankimit te ministri, i cili brenda 10 ditëve i përgjigjet ankuesit me shkrim.

Neni 10

Mbyllja e procedurës

Pas përfundimit të procedurave të mësipërme, ministria lidh kontratën e zhvillimit të aktivitetit, miraton kohëzgjatjen e projektit, i cili nuk mund të jetë me shumë se për 5 vjet për ujërat e brendshme dhe 10 vjet për akuakulturën intensive.

Neni 11

Rinovimi i lejes për peshkim dhe akuakulturë

Me mbarimin e afateve të lejuara sipas formatit të lejes ose kontratës për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit dhe akuakulturës, çdo subjekt peshkimi, i çfarëdo forme peshkimi, duhet të aplikojë nga fillimi, ashtu si është përcaktuar në nenet 4 dhe 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 12

Ndërprerja e lejes dhe prishja e kontratës

1. Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes dhe prishja e kontratës për zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturë është kompetencë e inspektorëve të peshkimit, si dhe e Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative (KSHKAPA).

2. Vendimi i KSHKAPA për ndërprerjen lejes dërgohet në QKL, e cila bën ndërprerjen e lejes.

3. Vendimi i KSHKAPA për ndërprerjen e kontratës i lëshohet me shkrim subjektit të kontratës.

4. Zotëruesi i lejes është i detyruar të dorëzojë pranë inspektorit të peshkimit ose zyrës së inspektoratit të peshkimit në rrethin përkatës dokumentin e lejes deri në vendimin e KSHKAPA dhe sanksioneve plotësuese.

Neni 13
Anulimi i lejes dhe kontratës

1. Leja ose kontrata humbet vlefshmërinë në mënyrë të përkohshme:
 - a) kur subjektit fizik ose juridik i ndalohet të zhvillojë aktivitetin e peshkimit dhe akuakulturës nga vendimi i KSHKAPA;
 - b) në rastet kur subjekti fizik ose juridik kryen shkelje të parashikuara në nenin 39 dhe nenin 40, germa “c” të ligjit;
 - c) kur subjekti fizik ose juridik nuk paguan taksën vjetore të lejes brenda datës 31 mars të vitit në vazhdim.
2. Leja ose kontrata humbet vlefshmërinë në mënyrë të përhershme kur:
 - a) përfundon ose mbyllet veprimtaria e peshkimit profesional;
 - b) zotëruesi i saj nuk dëshiron të vazhdojë veprimtarinë e peshkimit te lejuar nëpërmjet kësaj lejeje;
 - c) kur subjekti fizik ose juridik nuk paguan gjatë kohës së vendosura për shkeljet e konstatuara në bazë të neneve 39 dhe 40 të Ligjit;
 - d) kur subjekti fizik ose juridik është dënuar dy herë nga KSHKAPA;
 - e) kur subjekti fizik ose juridik, i ndodhur në kushtet e gërme “c” të pikës 1 të këtij neni, nuk e paguan taksën vjetore të lejes deri më datën 30 prill të po atij viti.
 - f) në rast se një mjet lundrues apo një impiant akuakulture nuk përdoret për zhvillimin e veprimtarisë për të cilën është marrë leje ose lidhur kontrate, për një periudhë më shumë se gjashtë muaj. Inspektori i peshkimit bën verifikimin dhe paraqet procesverbalin përkatës në drejtori.
 - g) në rast të moszbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga kushtet e lejes ose kontratës.
3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen edhe në rastin e licencave në fuqi, të lëshuara para ndryshimeve sipas ligjit nr.10 001, datë 6.10.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7908, datë 5.04.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën”, i ndryshuar .

Neni 14
Shfuqizimet

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, rregullorja nr.2, datë 7.5.2007 “Për licencimin e peshkimit dhe akuakulturës dhe rregullorja nr.3, datë 20.06.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr.2, datë 17.05.2007 “Për licencimin e peshkimit dhe të akuakulturës”, shfuqizohen.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT,
PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
Fatmir Mediu

KËRKESË
Nr.3823, datë 22.6.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Vora By Pass” Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkesë për shpronësim bëhet vetëm për pasurinë e llojit arë dhe objekte.

Pronarët për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP” do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë të rifreskuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e shpronësimit për tokën arë dhe për objektin është 7 756 953 (shtatë milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
 Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve
 Drejtoria e Shpronësimeve

LISTA E PASURIVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I MBIKALIMIT TË VORËS

Nr.	Pronari						Lloji i pasurisë	Çmimi	Vlera	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona	Nr.pas	Sip.m ²				
1.	Hasime	Bajram	Lamaj	2726	89/77	1543	arë	566	873338	Konf. nga ZRPP
2.	“Al Rexhina” Sh.p.k.			2726	89/76	1461	arë	566	826926	Konf. nga ZRPP
3.	Sulejman	Ali	Muça	2726	89/51	853	arë	566	482798	Konf. nga ZRPP
4.	Muharrem	Ali	Muça	2726	89/52	1168	arë	566	661088	Konf. nga ZRPP
5.	Sami	Osman	Muça	2726	89/110	1478	arë	566	836548	Konf. nga ZRPP
6.	Bujar	Osman	Muça	2726	89/111	553	arë	566	312998	Konf. nga ZRPP
7.	Shaban	Osman	Muça	2726	89/112	1124	arë	566	636184	Konf. nga ZRPP
8.	Nazmi	Osman	Muça	2726	89/113	1018	arë	566	576188	Konf. nga ZRPP
9.	Muharrem	Ali	Muça	2726	89/114	394	arë	566	223004	Konf. nga ZRPP
10.	Sylejman	Ali	Muça	2726	89/115	127	arë	566	71882	Konf. nga ZRPP
11.	B/pronarë		Muça	2726	89/18	343	arë	566	194138	Konf. nga ZRPP
12.	Ilmi		Haxhiu	2726			objekt		2061861	Konf. nga ZRPP
	Shuma					10062			7756953	

KËRKESË

Shtetësja Donika Karaj, e datëlindjes 29.9.1945, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, shtetasit Josif Karaj, i biri i Jorgjit dhe i Ollgës, i datëlindjes 31.12.1937.

KËRKUESJA
Donika Karaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 20.7.2010

Doli nga shtypi më 21.7.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë